

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Çështje procedurale (Seancë e hapur)

Faqe 1

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F469RED dhe F541

1 E mërkurë, 27 mars 2023

2 [Seancë e hapur]

3 [I akuzuari hyn në sallën e gjyqit]

4 --- Seanca fillon në orën 9.29

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

6 Mirëmëngjesi.

7 Znj. Sekretare e Gjykatës, ju lutem paraqisni lëndën.

8 SEKRETARJA E SEANCËS: [Përkthim] Mirëmëngjesi. Kjo është
9 çështja KSC-BC-2020-04, Prokurori i Specializuar kundër Pjetër
10 Shalës.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

12 Faleminderit.

13 Ju lutem palëve dhe Mbrojtësit të Viktimave të
14 prezantohen, duke filluar me Prokurorinë.

15 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Për Prokurorinë të pranishëm
16 sot kemi, Line Pedersen, menaxheren e rastit; Giulia Bianchi,
17 stazhiere; Filippo de Minicis edhe Gaia Pergolo si
18 bashkëprokurore.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

20 Mbrojtësi i Viktimave, fjala për ju.

21 Z. LAWS: [Përkthim] Mirëmëngjesi. Jam Simon Laws,
22 Mbrojtësi i Viktimave bashkë me bashkëmbrojtësen Maria
23 Radziejowska.

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

25 Faleminderit.

1 Ju lutem, Mbrojtja tani.

2 Z. GILISSEN: [Përkthim] Mirëmëngjesi. Unë jam Jean-Louis
3 Gilissen. Jam këtu në emër të z. Pjetër Shala. Këtu jam me
4 Hedi Aouini, bashkëmbrojtësin dhe bashkëmbrojtësen tjetër Leto
5 Cariolou, po ashtu Dzeneta Petravica, që është menaxhere e
6 çështjes. Po ashtu kemi Juliette Healy, asistente për
7 rishikimin e provave; Francisca De Castro, po ashtu Judit
8 Kolbe, po ashtu asistente për rishikimin e provave; Xhulia
9 Tepshi, është stazhiere dhe është shumë e rëndësishme sepse do
10 të ndihmojë dhe për të përkthyer për z. Shala sot. Po ashtu
11 Camille Gosson, stazhiere nga Franca. Faleminderit.

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
13 Faleminderit.

14 Sot fillojmë paraqitjen e provave nga ana e Prokurorisë
15 së Specializuar dhe këtu do të fillojmë me Dëshmitarin numër 8
16 të Prokurorisë.

17 Sikurse ju komunikuar nga njësia përkatëse, do të kemi
18 tre seanca nga ora 9.30 deri në 11.00; pastaj 11.30 deri në
19 13.00. Do bëjmë një orë pushim dhe pastaj do të kemi seancën e
20 fundit nga ora 14.00 deri në 16.00. E njëjta gjë vlen edhe për
21 të martën dhe për të mërkurën. Pastaj si të jenë zhvillimet do
22 të përdorim pastaj programin fillestar me një orë e gjysëm
23 pushim dreke. Kjo është ideja.

24 Përpara se të fillojmë me dëshminë e dëshmitarit, Trupi
25 Gjykues do të nxjerrë dy urdhra me gojë.

1 I pari lidhet me materialet që ZPS-ja synon të përdorë
2 gjatë pyetjes së tre dëshmitarëve të cilët do t'i ndjekim këtë
3 javë; përkatësisht 08, 07 dhe 09.

4 ZPS-ja ka kërkuar të përdorë dy harta të reja. Kërkesa u
5 bë me email më 21 mars, në orën 6.06 pasdite. Hartat u zbuluan
6 po në të njëjtën ditë, shkurtimisht, pasi erdhi emaili, pra,
7 në orën 18.09 të pasdites, paketa 110 kjo.

8 Mbrojtja u përgjigj më 23 mars 2023 po me email në orën
9 14.42. I vjen keq për vonesën në nxjerrjen e hartës,
10 megjithatë Trupi Gjykses vlerëson se është me rëndësi kjo
11 hartë dhe e ka pranuar.

12 Mbrojtësi i Viktimave nuk ka paraqitur asnjë kundërshtim.

13 Për të njëjtat arsye, Trupi Gjykses vendos të autorizojë
14 ZPS-në të përdorë dy hartat gjatë momentit që do të marrë në
15 pyetje dëshmitarët në përputhje me paragrafin 44 të Vendimit
16 mbi Zhvillimin e Proceseve që është parashtrimi i protokolluar
17 F434.

18 Këto harta janë krijuar rishtazi dhe u nxorën menjëherë
19 pas krijimit të tyre. Mbrojtja dhe Mbrojtësi i Viktimave patën
20 kohë të mjaftueshme t'i studiojnë. Do të ndihmojnë në marrjen
21 në pyetje të dëshmitarëve edhe Mbrojtja dhe Mbrojtësi i
22 Viktimave nuk kundërshtojnë kërkesën e ZPS-së.

23 Kemi një urdhër të dytë tani që lidhet me orientimet e
24 Trupit Gjykses në vendimin për zhvillimit e procesit gjyqësor
25 që palët dhe Mbrojtësit e Viktimave duhet të bëjnë me dije

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F469RED dhe F541

1 paraprakisht çdo pjesë që synojnë të përdorin në dokumente që
2 janë më të gjata se dy faqe kur të marrin në pyetje
3 dëshmitarët. Ky është parashtrim i protokolluar F434,
4 paragrafi 46, 48. Më 20 mars 2023, Mbrojtja i kërkoi Trupit
5 Gjykues me email në orën 19.43, të orientonte ZPS-në të bënte
6 me dije pasazhet që synonte të përdorte për Dëshmitarët 8 dhe
7 6, pra, përkatësisht nga dokumentet që synojnë të përdorin,
8 çka nuk e kishte bërë paraprakisht ZPS-ja.

9 Në alternativë, Mbrojtja i kërkon Trupit Gjykues të
10 sqarojë udhëzimin e saj në rast se ishte keqkuptuar.

11 ZPS-ja u përgjigj më 21 mars 2023 me email në 10.41
12 paradite. Trupi Gjykues mori vendim lidhur me këtë pikë më 21
13 mars 2023, po me email, në orën 12.26 të drekës. Trupi Gjykues
14 po e thotë këtë për procesverbal sepse ju e dini çfarë kemi
15 vendosur ne por duhet ta dijë edhe publiku dhe jo vetëm me
16 email. Prandaj duhet të respektojmë këtë formalitet, sepse
17 është e rëndësishme ta kemi në procesverbal, ta lexojnë të
18 gjithë. Dhe po ashtu dëshiroj t'ju bëj me dije sepse kjo
19 lidhet dhe me materiale që nuk janë vetëm deklaratat e
20 mëparshme të dëshmitarëve. Për masat që do të përdoren, sa do
21 të përdorin palët dhe Mbrojtësi i Viktimave deklaratat e
22 mëparshme gjatë marrjes në pyetje, do të varen nga dëshmia e
23 dëshmitarëve në Gjykatë. Për shembull, për t'ju kujtuar diçka
24 ose për të ballafaquar ndonjë mospërputhshmëri me deklaratat e
25 më përparshme. Nuk është e mundshme për palët dhe Mbrojtësin e

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Çështje procedurale (Seancë e hapur)

Faqe 5

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F469RED dhe F541

1 Viktimave të parashikojnë konkretisht cilat pjesë të
2 deklaratave të mëparshme do të përdorin me dëshmitarët.

3 Tetë nga materialet që ZPS-ja synon të përdorë me
4 Dëshmitarët 8 dhe 6 janë deklarata të mëparshme të
5 dëshmitarëve, sigurisht, Trupi Gjykses nuk sheh asnjë nevojë
6 për të urdhëruar ZPS-në të ndryshojë listën e materialeve.

7 Por është një material që nuk është deklaratë e
8 mëparshme, që ERN061216 deri në 061218 e redaktuar, që shfaqet
9 në listë lidhur me Dëshmitarin 08. Trupi Gjykses, po ashtu,
10 lidhur me këtë nuk gjykon se ishte e nevojshme të urdhëronte
11 ZPS-në të ndryshonte listën në lidhje me këtë situatë konkrete
12 se ZPS-ja ka bërë me dije pjesën që dëshiron të përdorë, pra,
13 njoftoi Mbrojtjen dhe Mbrojtësin e Viktimave, kështu që nuk ka
14 nevojë për të nxjerrë urdhër lidhur me këtë.

15 Këtu mbylлим dhe urdhrin e dytë të Trupit Gjykses.

16 Dua të diskutoj dhe një gjë të fundit. Mbrojtja, kemi
17 marrë parasysh kërkesën tuaj për shtyrje afati, parashtrimi
18 F467.

19 Dhe dua t'i drejtohem ZPS-së lidhur me këtë. Z. Prokuror,
20 a jeni në gjendje sot t'i përgjigjeni kërkesës së Mbrojtjes me
21 gojë?

22 Z. DE MINICIS: [Përkthim] E nderuar Gjykatëse, duke pasur
23 parasysh programin e kësaj jave, nuk e kundërshtojmë një
24 zgjatje të arsyeshme të këtij afati nëse dhe ju e gjykoni që
25 është e përshtatshme.

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F469RED dhe F541

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

2 Faleminderit. Shumë e shpejtë përgjigja juaj.

3 Tani i drejtohem Mbrojtësit të Viktimave.

4 Më falni, do i drejtohem pak më vonë Mbrojtësit të
5 Viktimave lidhur me këtë.

6 Së dyti, i nderuar Prokuror, Prokuroria a e ka të mundur
7 të informojë Trupin Gjykes aktualisht kur do të thërrisni
8 Dëshmitarin 01? E dimë që bazuar në urdhrin për zhvillimin e
9 procesit gjyqësor, nuk është përcaktuar ende por do të ishte e
10 dobishme ta dinim dhe nuk keni pse të përgjigjeni tani. Mund
11 të na përgjigjeni dhe më vonë. Po do të ishte e dobishme të
12 dinim nëse do ta thërrisni në javën e parë të majit apo në një
13 fazë të mëvonshme. Mund të na ndihmonte ne në vlerësimin e
14 kërkesës së Mbrojtjes.

15 Z. DE MINICIS: [Përkthim] E nderuar Gjykatëse, do ju
16 kontaktoj më vonë lidhur me këtë mbase gjatë ditës së sotme,
17 por aktualisht nuk kemi parashikuar ta kemi në bllokun e dytë
18 të paraqitjes së provave. Ka të ngjarë pas këtij blloku, po do
19 ju kontaktoj lidhur me këtë.

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

21 Faleminderit.

22 Mbrojtësi i Viktimave, ju a mund t'i përgjigjeni kërkesës
23 së Mbrojtjes? Flasim për gjithmonë parashtrimin 467.

24 Z. LAWS: [Përkthim] Asnjë kundërshtim prej nesh.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Çështje procedurale (Seancë e hapur)

Faqe 7

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F469RED dhe F541

1 Tani mund të fillojmë me dëshminë e dëshmitarit.

2 Asistentja e Gjykatës, ju lutem a mund të sillni
3 dëshmitarin në sallën e gjyqit. Faleminderit.

4 [Dëshmitari hyn në sallën e gjyqit]

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.

6 Dëshmitar, mirëmëngjes. Mirë se erdhët në Dhomat e
7 Specializuara. A më dëgjoni?

8 DËSHMITARI: Po.

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Nuk e
10 dëgjova përkthimin edhe njëherë ju lutem?

11 DËSHMITARI: Po.

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Tani
13 ju dëgjuam. Ndjesë.

14 Si jeni?

15 DËSHMITARI: Mirë. Faleminderit.

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
17 Faleminderit, z. Dëshmitar. Sot do të fillojmë me dëshminë
18 tuaj. Po para se të fillojmë, unë kam disa udhëzime.

19 Pikë së pari do t'ju shpjegoj masat mbrojtëse që janë
20 miratuar në lidhje me dëshminë tuaj.

21 Ju është dhënë një pseudonim, që do të thotë që nuk do ta
22 përmendim asnjëherë emrin tuaj por do t'ju drejtohem
23 gjithmonë me emrin "Z. Dëshmitar". Në mënyrë, që publiku të
24 mos e marrë vesh emrin tuaj. Po ashtu ju është ndryshuar zëri
25 dhe fytyra, që do të thotë askush jashtë kësaj salle gjyqi që

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F469RED dhe F541

1 po e përcjellë seancën nuk mund ta shohë fytyrën dhe nuk mund
2 ta dëgjojë zërin tuaj të vërtetë, gjatë kohës që do jepni
3 dëshmi.

4 Kur t'u përgjigjeni pyetjeve nuk do të zbulojmë
5 identitetin -- që nuk zbulohet identiteti juaj, do ta bëjmë në
6 seanca të hapura, që do të thotë që dhe publiku ta dëgjojë
7 çfarë po thuhet në sallën e gjyqit.

8 Kur t'ju kërkojmë të përshkruani çdo gjë që lidhet
9 specifikisht me ju ose që mund të zbulojë identitetin tuaj, do
10 ta bëjmë në seancë private këtë gjë, që do të thotë nuk do të
11 përcillet jashtë sallës së gjyqit dhe askush nuk mund të
12 dëgjojë çka po thuhet në këtë sallë.

13 Nëse thuhet ndonjë gjë gjatë seancës së hapur që mund të
14 zbulojë identitetin tuaj, ne do ta mbrojmë këtë informacion.

15 Dëshmia juaj do të përcillet me një vonesë dhe kemi
16 mundësinë që të heqim çdo informacion në mënyrë që të mos
17 përcillet për publikun dhe do ta heqim si dhe nga transkriptet
18 publike të procesit gjyqësor.

19 Masat mbrojtëse që unë ju sqarova, i keni të qarta z.
20 Dëshmitar

21 DËSHMITARI: Po, plotësisht.

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

23 Faleminderit, z. Dëshmitar.

24 Tani ju lutem edhe palëve, Mbrojtësit të Viktimave t'i
25 respektojnë masat mbrojtëse, të gjithë ne të jemi shumë të

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F469RED dhe F541

1 kujdesshëm gjatë marrjes në pyetje të dëshmitarit që të mos
2 zbulojmë asnjë informacion konfidencial.

3 Seanca do të jetë e hapur përveç nëse kërkohet ndryshe
4 nga palët në sallën e gjyqit.

5 Gjithashtu dua t'ju kujtoj sa i takon redaktimeve në
6 sallën e gjyqit, sikurse është përcaktuar në paragrafët 53
7 deri në 55, nëse jemi të gjithë të kujdesshëm do të kemi sa më
8 pak redaktime në sallën e gjyqit dhe do të ishte gjë shumë e
9 mirë kjo.

10 Mirë.

11 Z. Dëshmitar, edhe njëherë, ju kemi thirrur të jepni
12 dëshmi para Dhomave të Specializuara në çështjen Prokurori i
13 Specializuar kundër Pjetër Shalës të ndihmoni Trupin e
14 Gjykuesve që të dalë me vendim. Pasi të bëni deklaratën
15 solemne për të thënë të vërtetën, do ju bëjnë pyetje
16 përfaqësuesit e Prokurorisë, në të majtë pranë Gjykatësve me
17 togat ngjyrë vjollcë; përfaqësuesit që përfaqësojnë viktimat e
18 pranuar në këtë çështje, janë po ashtu në të majtën tuaj,
19 afër jush; dhe pastaj Mbrojtësi i z. Shala dhe ekipi i tij,
20 janë në të djathtë me togat që kanë ngjyrë të kuqe; dhe
21 përballë jush, jemi ne Gjykatësit e Trupit Gjykues. Mirë?

22 Do të doja t'ju jepja disa udhëzime për mënyrën sesi t'u
23 përgjigjeni pyetjeve që do t'ju drejtojnë.

24 Ju lutem, dëgjoni me kujdes secilën pyetje që do t'ju
25 drejtohet, nëse nuk e kuptoni, lirisht kërkoni që pyetja të

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F469RED dhe F541

1 përsëritet. Ne duam të na thoni të vërtetën. Të na thoni çka
2 keni parë, çka keni dëgjuar, çfarë keni përjetuar apo keni
3 ndjerë ju vetë. Nëse e keni zbuluar informacionin në mënyra të
4 tjera, na e thoni si e keni marrë vesh këtë informacion. Nëse
5 nuk ju kujtohen të gjitha detajet, është krejt normale. Mund
6 të thoni "S'e di", "Se mbaj mend". Dhe mos hamendësoni, ju
7 lutem.

8 Përgjigjuni pyetjeve. Nëse ka nevojë për më shumë
9 informacion ose duan më shumë sqarime, do ju bëjnë pyetje të
10 tjera për t'ju dhënë mundësinë që ta bëni më të qartë
11 përgjigjen.

12 I kuptoni të gjitha këto?

13 DËSHMITARI: Po.

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë
15 mirë. Tani disa këshilla praktike lidhur po ashtu me
16 përgjigjen e pyetjeve, z. Dëshmitar, çdo gjë që themi këtu
17 përkthehet dhe regjistrohet. Prandaj është e rëndësishme të
18 flisni para mikrofonit, të flisni qartë dhe të flisni ngadalë.
19 Sepse ju jep mundësinë përkthyesve, që janë diku lart, që të
20 përkthejnë çdo gjë që ju thoni.

21 Shumë e rëndësishme është që të ktheni përgjigje në
22 momentin që personi që ju ka bërë pyetjen e ka mbaruar vërtet
23 pyetjen e vetë. Edhe kur ju bëjnë pyetje, prisni pesë sekonda
24 përpara se të ktheni përgjigjen tuaj, sepse kjo i jep mundësi
25 përkthyesve të mbarojnë fjalinë, të përkthejnë atë që keni

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F469RED dhe F541

1 thënë ju, përndryshe do të kemi mbivendosje, do themi gjëra
2 njëkohësisht. Mund të jetë pak e vështirë në fillim, po në
3 qoftë se do ecni shumë shpejt, do ju ndërpresë unë vetë.

4 Nëse unë ngre dorën, ndaloni së foluri. Ndonjëherë unë
5 mund t'ju kërkoj të hiqni dëgjueset dhe do ju shoqërojnë
6 jashtë sallës së gjyqit sepse mund të ketë ndonjë pyetje që
7 lidhet me përmbajtjen e dëshmisë suaj, të cilën duhet ta
8 diskutojmë ne edhe është mirë në këto raste të jeni jashtë që
9 të mos influencoheni.

10 Nëse ju keni pyetje, keni nevojë për pushim, apo çdo gjë
11 që doni të komunikoni, ngrini dorën dhe unë do ju jap fjalën.
12 Në rregull?

13 I kuptuat të gjitha këto, z. Dëshmitar?

14 DËSHMITARI: Po. Faleminderit.

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë
16 mirë atëherë. Siç bëjmë me të gjithë dëshmitarët, do ju kërkoj
17 deklaratën solemne për të thënë të vërtetën. Dhe ju kujtoj se
18 është shkelje penale të jepni dëshmi të rreme në juridiksionin
19 e Dhomave të Specializuara.

20 E kuptoni?

21 DËSHMITARI: Po.

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

23 Asistente, ndihmoheni dëshmitarin të lexojë deklaratën solemne
24 për të thënë të vërtetën.

25 Z. Dëshmitar, lexoni tekstin që u është vënë përpara

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: TW4-08 (Seancë e hapur)

Faqe 12

Pyetje nga z. De Minicis

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F469RED dhe F541

1 DËSHMITARI: I ndërgjegjshëm për rëndësinë e dëshmisë sime
2 dhe përgjegjësinë time ligjore, deklaroj solemnisht se do të
3 them të vërtetën, krejt të vërtetën dhe vetëm të vërtetën dhe
4 nuk do të mbaj të fshehtë asgjë për të cilën kam dijeni.

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
6 Faleminderit. Tani jeni nën betim për të thënë të vërtetën.

7 Tani mund të fillojmë me dëshminë e Dëshmitarit 08, me
8 pyetjet nga Zyra e Prokurorisë së Specializuar.

9 Z. Prokuror, marr parasysh se keni parashikuar 2.5 orë
10 për pyetjet për këtë dëshmitar. Ju lutem, nëse ka ndonjë
11 ndryshim na bëni me dije. Faleminderit.

12 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Patjetër do ju njoftojmë për
13 çdo ndryshim që do të kemi për kohën që na nevojitet.

14 DËSHMITARI: TW4-08

15 Pyetje nga z. De Minicis:

16 PY. Mirëmëngjes, z. Dëshmitar. Sikurse dëgjuat dhe nga
17 Kryegjykatësja, ju keni masa mbrojtëse, ku përfshihet edhe
18 përdorimi i një pseudonimi, që të mbrojmë identitetin tuaj.
19 Kështu që do i kërkoja Trupit Gjykses shkurtimisht të shkojmë
20 në seancë private sa për të thënë të dhënat tuaja personale.
21 Dhe pastaj do të dalim përsëri në seancë publike dhe do të
22 përpiqemi që dëshminë tuaj ta kemi sa më shumë në seancë
23 publike.

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju
25 lutem, a mund të kalojmë në seancë private, Sekretare e

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: TW4-08 (Seancë private)

Faqe 13

Pyetje nga z. De Minicis

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F469RED dhe F541

1 Gjykatës?

2 [Seancë private]

3 [Seancë private teksti i fshirë]

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: TW4-08 (Seancë private)

Faqe 14

Pyetje nga z. De Minicis

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F469RED dhe F541

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: TW4-08 (Seancë private)

Faqe 15

Pyetje nga z. De Minicis

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F469RED dhe F541

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

[Seancë e hapur] Riklasifikuar në bazë të F541

11 PY. Një pyetje të fundit para se të dalim prapë në seancë

12 publike. Kuptoni anglisht?

13 PË. E kuptoj. E kuptoj, kam probleme pak në të folun.

[Seancë private]

14 [Seancë private teksti i fshirë]

15

16

17

18

19

20 [Seancë e hapur]

21 SEKRETARJA E SEANCËS: [Përkthim] jemi në seancë publike.

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

23 Faleminderit.

24 Z. Prokuror, vazhdoni me pyetjet tuaja.

25 Z. DE MINICIS: [Përkthim]

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: TW4-08 (Seancë e hapur)

Faqe 16

Pyetje nga z. De Minicis

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F469RED dhe F541

1 PY. Z. Dëshmitar, a jeni shqiptar i Kosovës?

2 PË. Po.

3 PY. Tani do t'ju bëj disa pyetje lidhur me periudhën e
4 pranverës së 1998.

5 Na treguat se ku banonit në maj 1998. A keni banuar me
6 njerëz të tjerë në atë kohë?

7 PË. Po. [REDAKTUAR]

8 PY. Sa vjeç keni qenë në atë kohë?

9 PË. Në atë kohë kam qenë [REDAKTUAR]

10 PY. Në maj 1998, a keni qenë anëtar i Ushtrisë Çlirimtare të
11 Kosovës?

12 [REDAKTUAR]

13 [REDAKTUAR]

14 [REDAKTUAR]

15 [REDAKTUAR]

16 [REDAKTUAR]

17 [REDAKTUAR]

18 [REDAKTUAR]

19 [REDAKTUAR]

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj.

21 Sekretare.

22 Ju kërkoj ndjesë që ju ndërpresë, z. Dëshmitar.

23 A mund të kalojmë në seancë private, ju lutem?

24 ~~[Seancë private]~~ [Seancë e hapur] Riklasifikuar në
bazë të F541

25 SEKRETARJA E SEANCËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: TW4-08 (Seancë e hapur)

Faqe 17

Pyetje nga z. De Minicis

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F469RED dhe F541

1 jemi në seancë private tani.

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju
3 falënderoj, znj. Sekretare.

4 Do i jap disa udhëzime dëshmitarit.

5 Z. Dëshmitar, të lutem të mos jepni informacion i cili
6 mund t'ju identifikojë juve apo gjëra rreth teje personalisht.
7 Pra, mos përmendni emrin e qytetit apo fshatit. Ne e dimë se
8 për cilin qytet apo fshat bëhet fjalë, nuk ka njeri në
9 galerinë e publikut këtu, kështu që ky informacion do të hiqet
10 nga transmetimi publik. Mos përmendni emrin e qytetit.

11 Po kështu nuk duhet të jepni hollësi edhe sesa anëtarë
12 apo pjesëtarë ka pasur familja juaj. Ne i dimë këto pasi janë
13 bërë pyetje.

14 Dhe po të kemi nevojë për informacione më të sakta, për
15 shifra e kështu me radhë, atëherë do të kalojmë përsëri në
16 seancë private.

17 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Po kështu.

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Dhe
19 nëse ka prapë pyetje të tjera, atëherë do të kalojmë në seancë
20 publike.

21 Znj. Sekretare, a mund të kalojmë në seancë publike?

22 DËSHMITARI: Mirë.

23 ~~{Seancë e hapur}~~

24 SEKRETARJA E SEANCËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
25 jemi në seancë të hapur.

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

2 Faleminderit.

3 Z. Prokuror, ju e keni fjalën.

4 Z. DE MINICIS: [Përkthim]

5 PY. Pra, z. Dëshmitar, që të dy ne duhet të tregohemi pak më
6 të kujdesshëm me këtë çështje.

7 Ju thatë që u bashkuat për të mbrojtur fshatin tënd.

8 Njësitet e UÇK-së në fshatin tënd, a kanë qenë pjesë e një
9 njësiti më të madh apo një selie më të madhe në atëkohë të
10 UÇK-së?

11 PË. Përafërsisht 30 burra apo 40.

12 PY. A ka qenë pjesë e një zone më të gjerë me një komandë më
13 të lartë apo pjesë e ndonjë zone më të gjerë, më të
14 gjerësishme të UÇK-së, pra, ky njësiti juaj i fshatit?

15 PË. Në fillim kem si fshat kemi qenë të organizum, për me
16 thënë duke u udhëzuar në atë të institucioneve të Republikës
17 së Kosovës, [REDAKTUAR]

18 [REDAKTUAR]

19 [REDAKTUAR]

20 PY. Faleminderit. Pra, vendi ku ke banuar në vitin 1998, sa
21 larg ishte nga Jabllanica?

22 PË. Nga Jabllanica ishte dy orë tri në këmbë, përafërsisht.

23 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, a mund të
24 shfrytëzohet tani hartën që është pjesë e provave materiale dhe
25 tani e kam fjalën për SPOE003330881 [sipas përkthimit].

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: TW4-08 (Seancë e hapur)

Faqe 19

Pyetje nga z. De Minicis

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F469RED dhe F541

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj.

2 Sekretare, ju lutem vazhdoni.

3 Z. DE MINICIS: [Përkthim]

4 PY. Z. Dëshmitar, a e shikon këtë hartë në ekran?

5 PË. Po.

6 PY. Nga informata që kemi, jemi përpjekur për të treguar
7 vendin nga ku vini dhe kemi vendosur një shenjë aty, siç e
8 shihni.

9 Ajo që shihni në ekran, a është ai vendi ku keni banuar
10 në prill të 1998?

11 PË. Po.

12 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, nëse kemi
13 teknologjinë, a mund t'i mundësojmë dëshmitarit që ta rrethojë
14 vendin ku ka banuar në vitin 1998, siç shihet në ekran?

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj.

16 Sekretare, a mund t'i jepni një laps dëshmitarit për të
17 treguar se ku ka banuar, nëse është në gjendje ta bëjë një gjë
18 të tillë.

19 DËSHMITARI: [Shënon]

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

21 Faleminderit që e keni rrethuar këtë emër të këtij vendi ku
22 keni banuar.

23 Z. DE MINICIS: [Përkthim]

24 PY. Faleminderit, z. Dëshmitar.

25 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, a mund të

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: TW4-08 (Seancë e hapur)

Faqe 20

Pyetje nga z. De Minicis

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F469RED dhe F541

1 shfaqim tani hartën tjetër e cila ka të njëjtin numër rendor
2 po në vend të numrit 1 ka numrin 2 në fund.

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

4 Vazhdoni, znj. Sekretare, ta ngarkoni këtë hartë.

5 SEKRETARJA E SEANCËS: [Përkthim] Më lejoni edhe një çast,
6 ju lutem. Më lejoni.

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

8 Dakord.

9 Kemi një problem teknik, kështu që nevojitet njësitë i
10 specializuar i kompjuteristikës për ta zgjidhur këtë çështje.

11 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Në qoftë se dëshironi, të
12 nderuar Gjykatës, mund të kaloj në çështje tjetër dhe ta bëj
13 këtë pyetje pas pushimit.

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po i
15 kërkoj sekretarisë të na japë sqarime, pasi në qoftë se keni
16 për të shfaqur në ekran prova të tjera, do e kemi disa
17 vështirësi. Kështu që pak durim.

18 Ju kërkojmë ndjesë, z. Dëshmitar, kemi një problem teknik
19 të vogël.

20 Z. Avokat, shoh që jeni ngritur në këmbë. Ju e keni
21 fjalën.

22 Z. AOUINI: [Përkthim] Nëse më lejoni, a mund të bëjmë një
23 propozim gjatë kësaj periudhe? Ndoshta mund ta bëj këtë në
24 publik.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Para

1 se ta bëni këtë është ky një propozim në të cilin mund të jetë
2 i pranishëm edhe dëshmitari që s'ka të bëjë me përmbajtjen e
3 dëshmisë së tij?

4 Z. AOUINI: [Përkthim] Do të përpiqem ta paraqes atë në
5 vija shumë të përgjithshme.

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
7 Vazhdoni.

8 Z. AOUINI: [Përkthim] Ne po e diskutonim këtë me njëri-
9 tjetrin dhe sugjerojmë që kolegët nga ZPS-ja të na japin një
10 dokument me një numër vendesh, pseudonimesh të cilat mund të
11 jenë konfidenciale dhe të cilën mund ta shfrytëzojë dëshmitari
12 me qëllim që ta bëjmë këtë në seancë publike pa pasur nevojë
13 që të hyjmë apo dalim në seanca. Ky dokument mund të ishte i
14 natyrës konfidenciale dhe aty do të paraqiten hollësitë e
15 veçanta, detaje të veçanta pa pasur nevojë për të kaluar në
16 seanca private.

17 Pra, një dokument për të cilin të dakordësohemi lidhur me
18 informatat që përmban, me qëllim që të mos kalojmë në seancë
19 private gjithë kohës. Faleminderit, të nderuar Gjykatës.

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
21 Faleminderit, z. Avokat. Do t'ia jap fjalën z. Prokuror dhe
22 Mbrojtësit të Viktimave të cilët nëse dëshirojnë të reagojnë
23 tani apo nëse dëshirojnë ta bëjnë këtë pak më vonë, e keni të
24 mundur.

25 Z. Prokuror, ju e keni fjalën.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: TW4-08 (Seancë e hapur)

Faqe 22

Pyetje nga z. De Minicis

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F469RED dhe F541

1 Z. DE MINICIS: [Përkthim] E kuptoj, i nderuar Gjykatës,
2 ne jemi përpjekur që t'i kufizojmë informatat që do të bëjmë
3 në seanca private që kanë të bëjnë me emrin e fshatrave,
4 informata të kësaj natyre. Nuk besoj që do të fitojmë ndonjë
5 gjë duke proceduar në këtë mënyrë, pasi informatat që do t'i
6 marrim në seancë private janë shumë të kufizuara. Nga ana
7 tjetër, ndoshta kjo gjë mund të ishte përgatitur paraprakisht
8 por tani nuk më duket se është mënyra më e mirë për ta bërë
9 një gjë të tillë. Nuk ka nevojë për ta ndërprerë seancën e
10 pyetjeve.

11 Unë do të përpiqem që të vazhdojë sa të jetë e mundur që
12 ta bëjë çdo gjë në publik por aktualisht nuk jam i mendimit që
13 ta pranoj sugjerimin që është bërë.

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
15 Mbrojtësi i Viktimave, ju e keni fjalën.

16 Z. LAWS: [Përkthim] Pasi i kam hedhur një sy pyetjeve që
17 kemi ne për këtë dëshmitar, unë mendoj se të gjitha mund t'i
18 bëjmë në seancë të hapur, në publike.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
20 Faleminderit, Mbrojtës i Viktimave.

21 Jam informuar që mund të vazhdojmë.

22 Faleminderit për sugjerimin tuaj. Kemi edhe disa kohë në
23 dispozicion. Dhe për ta shfrytëzuar si duhet kohën që kemi në
24 dispozicion do të vazhdojmë me paralajmërimet dhe me kujdesin
25 që kemi përmendur më herët. Megjithëkëtë, do të mbajmë

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: TW4-08 (Seancë e hapur)

Faqe 23

Pyetje nga z. De Minicis

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F469RED dhe F541

1 parasysht sugjerimin që keni bërë juve, do të shohim sesi ecim.
2 Por nga ana tjetër çdo sugjerim për të treguar kujdes për sa i
3 përket seancë private është i mirëpritur, megjithatë do të
4 vazhdojmë tani.

5 Z. Prokuror, e shoh që jeni ngritur në këmbë. Dëshët të
6 komentoni apo të vazhdoni të bëni pyetje dëshmitarit?

7 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Desha të vazhdoj me pyetjet për
8 dëshmitarin.

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
10 Dakord.

11 [Trupi Gjykses dhe Sekretarja e Gjykatës
12 këshillohen]

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.
14 Prokuror. Më kanë informuar se për shkak të problemeve
15 teknike, harta me emrin e fshatit të banimit nuk është ruajtur
16 bashkë me shënimin që ka bërë ai. Kështu që kërkesa është për
17 ta ribërë një gjë të tillë. Dhe prandaj do t'i kërkoja z.
18 Dëshmitar që të na tregonte edhe njëherë vendin ku ka banuar.

19 Z. Dëshmitar, kemi pasur një problem teknik dhe ai
20 rrethimi që i keni bërë vendit ku keni banuar, nuk është
21 ruajtur në sistem. Kështu që kërkesa ime për ju është, a mund
22 të na tregoni edhe njëherë se ku keni banuar në hartën që
23 ndodhet para jush në ekran?

24 Vazhdoni, ju lutem

25 DËSHMITARI: Po.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: TW4-08 (Seancë e hapur)

Faqe 24

Pyetje nga z. De Minicis

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F469RED dhe F541

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

2 Faleminderit, z. Dëshmitar. Tani do ta ruajmë.

3 Znj. Sekretare, ju lutem të më njoftoni sa të ketë
4 përfunduar kjo punë.

5 SEKRETARJA E SEANCËS: [Përkthim] Mund të vazhdojmë, e
6 nderuar Gjykatëse.

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
8 Faleminderit.

9 Z. Prokuror, ju e keni fjalën edhe njëherë.

10 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Faleminderit.

11 A mund të kërkoj ndihmën e sekretarisë tani për të
12 vendosur në ekran hartën tjetër, që ka të njëjtin numër rendor
13 por numrin 2 në fund dhe jo 1 si e mëparshmeja.

14 Ju lutem që pjesa që ka shënimin të mund të ngrihet pak
15 më lart. Ju lutem që hartën ta zbrisni pak më poshtë.
16 Faleminderit.

17 PY. Z. Dëshmitar, në hartën e mëparshme ju shënuat vendin ku
18 keni banuar në vitin 1998. Na thatë që ishte dy-tre orë ecje
19 në këmbë deri në Jabllanicë. A e sheh Jabllanicën në hartën që
20 ndodhet aty në ekran përpara jush? Nëse dëshironi që hartën ta
21 zmadhojmë, më thoni. Ju lutem, ta rrethoni.

22 PË. Ja. Përpara është quajtur Jabllanicë, tash quhet
23 Shqiponjë.

24 PY. Faleminderit.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] [Nuk

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: TW4-08 (Seancë private)

Faqe 25

Pyetje nga z. De Minicis

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F469RED dhe F541

1 ka mikrofon]. Deklaroj këtë për sa i përket procesverbalit, që
2 dëshmitari ka rrethuar emrin e fshatit me ngjyrë blu. Edhe
3 këtë do ta ruajmë në sistem.

4 Faleminderit, znj. Sekretare.

5 Z. DE MINICIS: [Përkthim]

6 PY. Z. Dëshmitar, tani që e kemi identifikuar vendin ku ke
7 banuar në vitin 1998 dhe na keni ndihmuar në hartë, tani dua
8 të kaloj dhe të flasim për babain tuaj. Do të tregohemi të
9 kujdesshëm për të mos e përmendur emrin e tij për të ruajtur
10 identitetin tuaj dhe as dhe asnjë hollësi të mëtejshme se ku
11 ka punuar pasi kjo është pyetje këto janë pyetje që do i bëjmë
12 më pas.

13 Në vitet 1990, çfarë pune ka bërë babai?

14 PË. Prej vitit 1990 deri në vitin 1997 ka punuar në polici.

15 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, ju lutem
16 që të kalojmë shkurtimisht në seancë private për të bërë nja
17 dy pyetje të cilat mund të shërbejnë për identifikim.

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj.
19 Sekretare, ju lutem të kalojmë në seancë private.

20 [Seancë private]

21 [Seancë private teksti i fshirë]

22

23

24

25

Dëshmitari: TW4-08 (Seancë private)

Faqe 26

Pyetje nga z. De Minicis

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F469RED dhe F541

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18 [Seancë e hapur]

19 SEKRETARJA E SEANCËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
20 jemi në seancë publike.

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

22 Faleminderit, znj. Sekretare.

23 Vazhdoni, z. Prokuror.

24 Z. DE MINICIS: [Përkthim]

25 PY. Z. Dëshmitar, na thatë që babai juaj ka shërbyer si

1 oficer policie në vitin 1997. Përse e ndaloi punën si oficer
2 policie atë vit?

3 PË. Atë vit, përkund të rrethanave të luftës, domethënë,
4 shteti, Serbia, Ministri i Punëve të Brendshme i cili e ka
5 qitë në pension të dhunshëm. Për punë, që veç ish një situatë
6 jo e mirë apo qëllimet e tyre, nuk di, Vlastimir Gjorgjeviç, i
7 cili ka qenë i dënuar në këtë Gjykatë për krime lufte. Ka
8 dokumentacionin. Ka të gjitha sendet.

9 PY. Faleminderit. A e di arsyen se përse ky person e ka
10 detyruar babain të dalë në pension?

11 PË. Mendoj që ka qenë shqiptar.

12 PY. Faleminderit. Për shkak të punës që ka bërë, a ishte
13 babai i njohur, i mirënjohur në komunitet?

14 PË. Po. Atë mund edhe komunitetin ta pyetni për punën e tina.
15 Dhe nuk ka qenë asnjëherë i akuzum nga komuniteti për gjëra
16 kriminale apo diçka tjetër jashtë ligjore.

17 PY. Punësimi në forcën policore a ka ndikuar në pozitën që ka
18 pasur familja juaj në komunitet? Në marrëdhëniet tuaja me
19 fqinjët për shembull?

20 PË. Më falni edhe njëherë pyetjen a bën?

21 PY. Dakord. Puna si oficer policie e babait tuaj a ka ndikuar
22 lidhur me marrëdhëniet që ka pasur familja juaj me komunitetin
23 rreth e rreth?

24 PË. Po, ka ndiku ajo. Ka ndiku. Për atë arsye, besoj, që për
25 atë arsye e kanë qitë në pension të dhunshëm.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: TW4-08 (Seancë private)

Faqe 28

Pyetje nga z. De Minicis

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F469RED dhe F541

1 PY. A mund të na japësh hollësi të mëtejshme lidhur me
2 mënyrën sesi puna e tij si oficer policie ka ndikuar në
3 familjen tuaj në marrëdhëniet tuaja si familje me komunitetin
4 ku keni banuar?

5 PË. Në komunitetin ku kemi banuar, gjithçka ka qenë në
6 rregull. Domethënë, ka qenë në marrëdhënie të mira me
7 komunitetin. Ka pasur raporte të shkëlqyeshme me drejtorë të
8 shkollave, me persona aty që kanë qenë përgjegjës nëpër
9 rrethin, komunën. Marrëdhënie të shkëlqyeshme dhe mbrojtjen e
10 atij rajoni të Dushkajës ku nuk është bë asgjë ligjore. Asgjë
11 jashtë ligjit nuk ka lënë që të bëhet. Dhe më pas kanë pasu
12 edhe shkarkimi i tij i dhunshëm në vitin 1997.

13 PY. Faleminderit për shpjegimin. Shumë faleminderit.

14 Babai juaj politikisht a ka qenë aktiv në vitet 1990 deri
15 1998, pra, a ka qenë politikisht aktiv?

16 PË. Politikisht aktiv nuk ka qenë, po si familje dhe babai
17 im, personalisht, e kanë përkrahë Lidhjen Demokratike të
18 Kosovës, të cilën e ka udhëheqë presidenti i ndjerë Ibrahim
19 Rugova.

20 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, a mund të
21 kalojmë shkurtimisht në seancë private për nja dy pyetje?

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po.

23 Sekretare e Gjykatës, ju lutem a mund të shkojmë në
24 seancë private.

25 [Seancë private]

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: TW4-08 (Seancë private)

Faqe 29

Pyetje nga z. De Minicis

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F469RED dhe F541

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

[Seancë e hapur] *Riklasifikuar në bazë të F541*

5 PY. Babai juaj a ka bërë ndonjë punë me pjesëtarët e LDK-së?

6 PË. Ka bisedu me ta. Ka ndjejtë. Ka pasë marrëdhënie të

7 shkëlqyeshme. E gjithë familja jonë kemi qenë në Lidhjen

8 Demokratike të Kosovës, ku posedojmë faktet, librezat,

9 anëtarësimi dhe të gjitha kontributet të cilat i kemi dhënë në

10 atëkohë.

[Seancë private]

11 [Seancë private teksti i fshirë]

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: TW4-08 (Seancë private)

Faqe 30

Pyetje nga z. De Minicis

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F469RED dhe F541

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: TW4-08 (Seancë private)

Faqe 31

Pyetje nga z. De Minicis

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F469RED dhe F541

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6 [Seancë e hapur] Riklasifikuar në bazë të F541

PY. Z. Dëshmitar, ju na thatë që babai juaj ka pasë

7 marrëdhënie të shkëlqyera me pjesëtarët e LDK-së. Kur ju

8 intervistuar [REDAKTUAR], ju thatë, pasi ju pyetëm nëse

9 babai ka qenë aktiv politikisht:

10 "I angazhum politikisht s'ka qenë, po ka ndejtë me njerëz

11 që kanë qenë të LDK-së".

[Seancë private]

12 [Seancë private teksti i fshirë]

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: TW4-08 (Seancë private)

Faqe 32

Pyetje nga z. De Minicis

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F469RED dhe F541

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

[Seancë e hapur] Riklasifikuar në bazë të F541

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Do

22 t'i jap fjalën kolegut për të bërë një pyetje më sqaruese

23 mbase në këtë drejtim.

24 I nderuar Dëshmitar, kolegu do ju bëjë një pyetje.

25 GJYKATËSI BITTI: [Përkthim] Kam një pyetje të thjeshtë.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: TW4-08 (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F541
Pyetje nga z. De Minicis Faqe 33
Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F469RED dhe F541

1 Nga çka thatë ju, a mund të kuptojmë ne që të gjithë fëmijët e
2 komuniteteve të ndryshme shkonin në të njëjtën shkollë? Pra,
3 fëmijët nga komuna të ndryshme apo nga regjione të ndryshme
4 shkonin në të njëjtën shkollë? Këtë po na thoni? Apo nga zona
5 të ndryshme - më falni -

6 DËSHMITARI: Jo. Regjioni i Dushkajës, domethënë, ka pasë
7 vende të tjera ku kanë qene regjione, për shembull, nëpër
8 Gjakovë, nëpër komuna tjera apo regjione të tjera kanë mësu
9 edhe nëpër shtëpia private, kisha dhe xhamia duke ju mohuar e
10 drejta në shkollë, në institucionin shkollor. Kurse në
11 regjionin e Dushkajës të gjitha shkollat që kanë qenë shkollat
12 fillore, kanë punuar duke e marrë Becin, Meqe, Jabllanicë,
13 Zhebel, Gërgoc, Kralan, Cermjan, të gjitha shkollat kanë
14 funksionuar në institucionet shkollore, objektet shkollore jo
15 nëpër shtëpia private, xhami apo kisha.

16 Këtë dua ta sqaroj. E dinë të gjithë komuniteti.

17 GJYKATËSI BITTI: [Përkthim] Prapë përsërisë pyetjen. A do
18 të thotë kjo se fëmijët nga komunitete të ndryshme shkonin në
19 një shkollë të vetme, pra, në vend që të shkonin në shkolla
20 apo në ndërtesa fetare shkonin në shkollë, pra, nuk shkonin në
21 godina fetare? Këtë po na thoni?

22 DËSHMITARI: Po, në të njëjtën.

23 GJYKATËSI BITTI: [Përkthim] Në të njëjtën shkollë pra?

24 DËSHMITARI: Po.

25 GJYKATËSI BITTI: [Përkthim] Faleminderit.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: TW4-08 (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F541
Pyetje nga z. De Minicis Faqe 34
Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F469RED dhe F541

- 1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
- 2 Faleminderit.
- 3 Prokuror, vazhdoni me pyetjet.
- 4 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Ne jemi ende në seancë private?
- 5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po.
- 6 Z. DE MINICIS: [Përkthim]
- 7 PY. Faleminderit për sqarimin, z. Dëshmitar. Po në lidhje me
- 8 këtë. Ju na treguat si funksiononte në zonën e Dushkajës dhe
- 9 na renditët një numër fshatrash. Aty përmendët dhe
- 10 Jabllanicën. Me të drejtë kështu?
- 11 PË. Po.
- 12 PY. Pra, Jabllanica ishte pjesë e zonës së Dushkajës,
- 13 regjionit të Dushkajës?
- 14 PË. Po.
- 15 PY. Faleminderit. Një pyetje të fundit në seancë private. Dhe
- 16 pastaj kalojmë në seancë publike.
- 17 Ju na thatë që familja juaj mbështeste LDK-në me babain.
- 18 A njihej kjo në komunitet, dihej në komunitet diçka e tillë?
- 19 PË. Po. I gjithë komuniteti e dinë.
- 20 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, tani mund
- 21 të kalojmë në seancë publike.
- 22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj.
- 23 Sekretare e gjykatës, ju lutem kalojmë në seancë publike.
- 24 ~~{Seancë e hapur}~~
- 25 SEKRETARJA E SEANCËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

2 Vazhdoni, z. Prokuror.

3 Z. DE MINICIS: [Përkthim]

4 PY. Z. Dëshmitar, na thatë vendin ku keni jetuar me familjen

5 tuaj në maj të 1998. A jetuat në të njëjtën shtëpi gjatë

6 gjithë verës së vitit 1998?

7 PË. Po. Të gjithë.

8 PY. Pra, në qershor, korrik të vitit 1998, po jetoje në të

9 njëjtën shtëpi që kishe jetuar me familjen dhe në maj apo jo?

10 Kështu?

11 PË. Po.

12 PY. Në rregull. A i ndodhi ndonjë gjë familjes suaj në maj të

13 vitit 1998?

14 PË. Po. Në pjesën e mbramë të majit, sa më kujtohet, pjesën e

15 mbramë të majit kanë ardhë dy persona të Ushtrisë Çlirimtare

16 të Kosovës nga Jabllanica, Hamëz Ibrahimaj dhe një person

17 tjetër edhe ai Ibrahimaj, Naser Ibrahimaj. Herën e parë, dy

18 persona, këta dy kanë qenë ku kanë ardhë në shtëpi dhe kanë

19 fol me vëllanë gjoja për dorëzimin armëve që i kem pasë për

20 mbrojtjen e fshatit. Vëllavi i ka thënë që baba nuk është

21 këtu. Unë ata dy persona ka kanë dalë, jam taku me ta te rruga

22 e shtëpisë time dhe ju kam thanë që -- më kanë bë pyetje më

23 kanë thanë armët që i keni duhet me i dorëzu. Unë i kam thanë

24 që armët i kemi për mbrojtjen e fshatit dhe nuk është e

25 arsyeshme për me i dorëzu. Ky është urdhri i Lahi Brahimit.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: TW4-08 (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F541
Pyetje nga z. De Minicis Page 36
Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F469RED dhe F541

1 Kështu kanë thënë.

2 Dhe pas dy dite apo tri dite, kanë ardhë, Naser
3 Ibrahimaj, Hamëz Ibrahimaj, me një togë ushtarësh të cilët
4 kanë qenë të sistemuar nga gardhi i shtëpisë me automatik, me
5 tromblon për - tromblon është për objekte, shkatërrimin e
6 objekteve arma tromblon. Dhe Naser Ibrahimaj dhe Hamëz
7 Ibrahimaj kanë ardhë në oborr mrenda, kurse të tjerët kanë
8 qenë rreth gardhit të shtëpisë. Ku shtëpia jonë kishte 20-25
9 metra nga largësia ku ishin të pozicionuar. Disa kanë qenë me
10 maska, disa kanë qenë me kapela dhe na kanë thënë që t'i
11 dorëzojmë armët. Ne armët nuk i kemi dorëzu se i kemi pasë për
12 mbrojtje për luftë.

13 Dhe më pas [REDAKTUAR] -- aty ka shku një
14 kohë. Disa thojshin nga gardhi, që i thojshin këtyne dyve që
15 ishin në oborr, ikni se po dojmë me i gjuajmë shtëpinë
16 [REDAKTUAR]. Më pas [REDAKTUAR] ja kanë marrë

17 një revole vëllaut tim, [REDAKTUAR]
18 dhe nëna ime ju ka thënë [REDAKTUAR]
19 [REDAKTUAR]
20 [REDAKTUAR]
21 [REDAKTUAR]

22 PY. [Nuk ka përkthim].

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] [Nuk
24 ka përkthim].

25 ~~{Seancë private}~~ [Seancë e hapur] Riklasifikuar në
bazë të F541

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: TW4-08 (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F541
Pyetje nga z. De Minicis Faqe 37
Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F469RED dhe F541

1 SEKRETARJA E SEANCËS: [Përkthim] Jemi në seancë private.

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

3 Vazhdoni, z. Prokuror.

4 Z. DE MINICIS: [Përkthim]

5 PY. Z. Dëshmitar, është mbase dhe falja ime. Duhet t'ju

6 kërkoj falje, duhet ta kishim bërë mbase në seancë private.

7 Duhet të mos përmendni emra e anëtarë të familjes. [REDAKTUAR]

8 [REDAKTUAR]

9 [REDAKTUAR]. E dimë që është e vështirë t'i mbani mend të
10 gjitha dhe t'u kushtosh rëndësi. Por, sigurisht, që ne duam që
11 ta kemi seancën publike, ka dhe rreziqet e veta kjo gjë.

12 Tani jemi në seancë private, prandaj desha, në fakt, t'ju
13 thosha që të jemi të kujdesshëm.

14 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Kështu që, të nderuar Gjykatës,
15 mbase është nevoja që t'i bëjmë disa redaktime pjesës ku
16 dëshmitari -- të paktën pjesën e fundit të dëshmisë së
17 dëshmitarit.

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
19 fakt, janë duke e bërë aktualisht, kështu që do të shohim
20 çfarë propozon ZPS-ja dhe çfarë kemi bërë ne. Po e kemi
21 parasysh dhe po e bëjmë ndërkohë.

22 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Tani mbase në këtë pikë nuk do
23 ishte shumë e këshillueshme të shkonim në seancë publike, ka
24 disa rreziqe. Sepse kuptohet që ka dhe një vonesë në
25 përcjellje, ju mund të vendosni ose të kalojmë në seancë

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: TW4-08 (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F541
Pyetje nga z. De Minicis Faqe 38
Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F469RED dhe F541

1 publike dhe të bëni redaktimet përkatëse ose të rrimë në
2 seancë private.

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

4 Atëherë do të vazhdojmë me seancë private për momentin. Dhe
5 dua t'ju bëj me dije se dhe tetë minuta kohë kemi para se të
6 bëjmë pushimin.

7 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Në rregull. Do të bëj nja dy
8 pyetje sqaruese edhe më pas flasim për këtë incident më në
9 hollësi.

10 PY. Z. Dëshmitar, jemi në seancë private tani. Ditën kur
11 erdhën këta persona në shtëpinë tuaj, ju vetë a ishit në
12 shtëpi atë ditë?

13 PË. Po.

14 PY. Jeni i sigurtë që ishit në shtëpi atë ditë?

15 PË. I sigurtë 100 për qind. E gjithë familja kemi qenë aty
16 prezent.

17 PY. Po ju pyes sepse kemi një dokument të vitit 2002.

18 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Ja ta nxjerrim në ekran. Është
19 dokumenti 200206 RED - më falni - 200201618-6218 RED.

20 Kemi dhe anglishten dhe shqipen që ka të njëjtin numër
21 provash dhe shohim paragrafin e parë në faqen e parë.

22 PY. Dua të na e sqaroni ose ta sqaroni për Trupin Gjykses.

23 Këto janë shënime që i ka marrë një hetues [REDAKTUAR]

24 [REDAKTUAR]. Këto shënime, paragrafi i parë,

25 duket sikur thuhet aty:

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: TW4-08 (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F541
Pyetje nga z. De Minicis Faqe 39
Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F469RED dhe F541

1 "Unë nuk isha në shtëpi në ato momente".

2 E shihni?

3 "Unë nuk isha në shtëpi në ato momente", thuhet në
4 paragraf.

5 Thua:

6 "Unë nuk isha në shtëpi në atë kohë".

7 PË. Po, kur kanë ardhë dy personat, kur kanë ardhë dy
8 personat herën e parë Hamëz Ibrahimaj e ata, unë nuk kam qenë
9 aty. Ka qenë vetëm vëllau. Mirëpo, unë i kam taku te dera. Dhe
10 kur kanë ardhë këta dy mrenda në oborr, herën e dytë është
11 kjo, me ushtarë tjerë të UÇK-së të cilët kanë mujt me qenë 10
12 deri në 15 persona jashtë gardhit, disa me maska dhe disa
13 vetëm me kapela, me automatik dhe tromblona, kam qenë prezent.

14 PY. Faleminderit për sqarimin, z. Dëshmitar.

15 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, ka dhe nja
16 pesë a gjashtë minuta kohë, por do sugjeroja ta bëjmë pushimin
17 pesë minuta më përpara dhe pastaj të flasim më në hollësi për
18 incidentin.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

20 Faleminderit, z. Prokuror.

21 Kalojmë në seancë publike.

22 ~~{Seancë e hapur}~~

23 SEKRETARJA E SEANCËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

25 Faleminderit.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: TW4-08 (Seancë e hapur)

Faqe 40

Pyetje nga z. De Minicis

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F469RED dhe F541

1 Z. Dëshmitar, tani kemi kohën të bëjmë një pushim. Do
2 bëjmë gjysëm ore pushim. Asistentja e Gjykatës do ju shoqërojë
3 jashtë sallës së gjyqit dhe do takohemi këtu në orën 11.25
4 sërish. Faleminderit.

5 DËSHMITARI: Faleminderit prej juve.

6 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë.

8 Takohemi për gjysëm ore.

9 Seanca mbyllet këtu.

10 --- Pauza fillon në orën 10.56

11 --- Seanca rifillon ne orën 11.26

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Uluni

13 ju lutem.

14 Mirë se vini sërish.

15 Përpara se t'i kërkoj sekretarisë që të sjellim

16 dëshmitarin në sallë edhe një herë, po i hedh sytë për të parë

17 nëse jemi me të njëjtin përbërje.

18 Shoh që ZPS-ja ka të njëjtët njerëz.

19 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Po, jemi të njëjtët.

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

21 Mbrojtësi i Viktimave, në të njëjtën përbërje. E shoh që po

22 pohoni me kokë.

23 Dhe pala e Mbrojtjes.

24 Z. GILISSEN: [Përkthim] Jemi të njëjtën përbërje.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: TW4-08 (Seancë e hapur)

Faqe 41

Pyetje nga z. De Minicis

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F469RED dhe F541

1 Faleminderit, dhe z. Shala është i pranishëm.

2 Zonja Sekretare, ju lutem të sjellim dëshmitarin në
3 sallë.

4 Tani do të ri fillojmë dëshminë e dëshmitarit 08.

5 [Dëshmitari vijon dëshminë]

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju
7 lutem.

8 Mirë se vini edhe një herë, z. Dëshmitar, më dëgjoni?

9 DËSHMITARI: Po, faleminderit.

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
11 Dakord. Për një çast po bisedoj me Sekretaren e Gjykatës.

12 [Anëtarët e Trupit Gjykues këshillohen]

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
14 Faleminderit për durimin tuaj. Do të vazhdojmë tani.

15 Z. Prokuror, ju e keni fjalën për të vazhduar pyetjet për
16 Dëshmitarin.

17 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar
18 Gjykatës. Jemi në seancë publike, apo jo?

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po,
20 gjithmonë e fillojmë seancën në seancë publike.

21 Z. Prokuror, ju kërkoj ndjesë. Duhet të them një gjë
22 këtu, dhe është një koment i përgjithshëm për të gjithë. Më
23 kanë kërkuar që të tregoj vëmendje të veçantë me butonin e
24 mikrofonit. Kështu që kur është duke folur dëshmitari, ju
25 lutem të mbyllni mikrofonin tuaj, me qëllim që të mos lejohet

1 që të dalë nga salla zëri i tij.

2 Ju e keni fjalën, z. Prokuror.

3 Z. DE MINICIS: [Përkthim]

4 PY. Z. Dëshmitar, mirë se vini edhe një herë. Para pushimit
5 po flisnim për majin e vitit 1998, kur një grup njerëzish kanë
6 ardhur te shtëpia juaj dhe kam disa pyetje vijuese. Pyetja e
7 parë: këta njerëz, a ishin me uniformë?

8 PË. Po. Disa -- disa kanë qenë me uniformë, por disa me
9 uniformë dhe me rroba civile -- kështu. Por, përgjithësisht me
10 uniformë.

11 PY. A kishte ndonjë emblemë në uniformat e tyre?

12 PË. Po. Kryesisht ata të dy që kanë qenë në oborr, kanë qenë
13 me emblema. Kurse ata të tjerët që kanë qenë te gardhi, zidi,
14 i shtëpisë, s'kam mundur t'i identifikoj. Largësia ka qenë 20-
15 25 metra largësi.

16 PY. Ata dy personat që kanë ardhur më afër, çfarë shenje,
17 çfarë embleme kanë pasur në uniformën e tyre?

18 PË. Ka qenë shenja e UÇK-së.

19 PY. Thatë më herët që këta njerëz ishin të armatosur dhe po i
20 referohem faqes 31, rreshti 11, 12 i transkriptimit. Thatë që
21 kishin një armë për shkatërrimin e shtëpisë.

22 A mund ta sqaroni, për çfarë bëhet fjalë?

23 PË. Armë për shkatërrimin e shtëpisë ne atij i kemi thënë
24 "tromblon". Domethënë, kundër ndërtesave të fortifikuara.

25 PY. Faleminderit për këtë sqarim. Në faqen 32, në rreshtin 1

1 deri në 3, thatë që këta persona kanë biseduar fillimisht me
2 vëllain. I kanë kërkuar armët, dhe ai u ka thënë që babai nuk
3 ishte në shtëpi. A kishin ardhur ata për të kërkuar babanë,
4 prandaj e thatë një gjë të tillë?

5 PË. Po. Po, por, babanë e kemi fshehur në dhomë. Domethënë,
6 përkund -- mos me ardhur deri te më e keqja e mundshme, si ma
7 kujt me ardh.

8 PY. A treguan konkretisht se çfarë donin nga babai?

9 PË. Që të vijë - e kemi urdhrin nga Lahi Brahimi që t'i
10 dorëzoni armët dhe të vijë në shtabin e Jabllanicës."

11 PY. Faleminderit. A shkoi me ta babai?

12 PË. Jo.

13 PY. Keni përmendur emrat e dy personave që ishin në këtë
14 grup. A keni njohur ndokënd tjetër që ishte pjesë e atij grupi
15 atë ditë?

16 PË. Atë ditë vetëm dy personat, të cilët kanë qenë në oborr i
17 kam njohur me emër, dhe kështu -- që janë prezantuar. Gjoja që
18 me urdhër të shtabit. Dhe më vonë ndërkohë, sipas informatave,
19 përmes komshinjve, përmes ish luftëtarëve të UÇK-së, kam mujt
20 të informohemi që ka qenë Pjetër Shala me pseudonimin "Ujku".

21 PY. Në atë kohë, a ke njohur Pjetër Shalën?

22 PË. Kurrë në jetën time s'e kam njohur.

23 PY. Atëherë, a mund të na shpjegosh se si e mësove që ai
24 ishte mes atyre njerëzve të atij grupi? Se ta fillojmë,
25 fillimisht, kush ta ka treguar fillimisht këtë?

1 PË. Këtu, fillimisht -- pasi se babanë tim e kanë mbajtur për
2 disa kohë në Kukës, në fabrikën me hekurishte -- si të themi,
3 fabrikë hekurishtesh. Aty Pjetër Shala personalisht me babanë
4 tim ka ushtruar dhunë, forcë, elektroshok, bejsboll, bishta të
5 sakicë, bishta të sakicë, domethënë, dhe rrahje masive me të
6 gjithë të ndaluarit të tjerë, së bashku.

7 PY. Do të vijmë te kjo pikë më vonë por përgjigju pyetje
8 saktësisht. Si e more vesh që Pjetër Shala ishte pjesë e
9 grupit që ka ardhur te shtëpia juaj atë ditë në maj të vitit
10 1998.

11 PË. Aty, kur kanë qenë -- kanë qenë disa komshinj, kur kanë
12 ardhur aty dhe u kanë atyre se "çfarë po lypni këtu? Sa jeni,
13 kah doni" Këta që kanë qenë aty ushtria, te gardhi, u kanë
14 thënë "ik, largohuni andej". edhe aty e kanë identifikuar se
15 është Pjetër Shala, kur unë jam interesuar për rastin, kush
16 është, kush ka mujt me qenë. Është Pjetër Shala, dhe më kanë
17 thënë që njeri i cili ka qenë me tromblon, për ndërtesat e
18 fortifikuara, i pari te dera, ka qenë Pjetër Shala. Njerëz që
19 e kanë njohur. Unë s'e kam njohur.

20 PY. Na thatë që mësuat nga fqinjët që një nga këta persona
21 ishte Pjetër Shala. Po përmes kanaleve të tjera, apo ndonjë
22 personi tjetër, a e keni mësuar të njëjtën gjë? Përveç
23 fqinjëve, pra.

24 PË. Përmes fqinjëve dhe përmes babës, dhe përmes njerëzve të
25 tjerë, luftëtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

1 PY. Në fakt pyetja tjetër që kisha ishte nëse keni dijeni se
2 si e dinin ata njerëz që ishte Pjetër Shala. Ata njerëz që të
3 thanë ty që ky ishte Pjetër Shala? Si e dinin ata që ky është
4 Pjetër Shala?

5 PË. Ata njerëz e kanë njohur se kanë vepru me të.

6 PY. Ku, si kanë vepruar me të? Në ç'vend?

7 PË. Në luftë. Mbas tërheqjes së familjes time, domethënë, e
8 kanë njohur shumë mirë, kush është, [REDAKTUAR]

9 [REDAKTUAR]

10 [REDAKTUAR]

11 PË. A ta kanë dhënë komshinjtë këtë emër, specifikisht, pra
12 emrin Pjetër Shala, apo të kanë dhënë ndonjë emër, apo mbiemër
13 tjetër.

14 PË. Pseudonimin "Ujku", q'ashtu është quajtur.

15 PY. Z. Dëshmitar -

16 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, do t'ju
17 lutem të shfrytëzojmë deklaratën e Tribunalit të Hagës, të
18 dëshmitarit të vitit 2010, që ka numrin rendor U0174052-
19 U0174053, e redaktuar.

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
21 Vazhdoni, znj. Sekretare.

22 Z. DE MINICIS: [Përkthim]

23 PY. Z. Dëshmitar, a ju kujtohet që t'i keni dhënë dëshmi
24 Tribunalit Penal për ish-Jugosllavinë në vitin 2010?

25 PË. Po.

1 PY. Kur po përgatitesha për dëshminë tuaj e lexova këtë
2 deklaratë, dhe vërejta që në atë kohë nuk e keni përmendur
3 këtë informacion që po na thoni ne sot, që Pjetër Shala ka
4 qenë një nga personat që kanë ardhur te shtëpia juaj. A ka
5 ndonjë arsye të veçantë është e bën të mundur që ju t'ju
6 kujtohet sot një gjë e tillë, ndërkohë që ky emër nuk është
7 pjesë e kësaj deklarate?

8 PË. [REDAKTUAR]

9 [REDAKTUAR]

10 [REDAKTUAR]

11 [REDAKTUAR]. Unë kam qenë në shtëpinë, se nuk na prite
12 kur erdhëm për të arrestuar, me të marrë armët dhe ty". Dhe
13 dhunën që e ka shkaktuar, me gjithë shokët e tjerë në Kukës,
14 një brutalitet, çka asht jashtë njerëzore.

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.
16 Dëshmitar, ju lutemi përgjigjuni pyetjes që bën Prokurori. Ai
17 pyeti se përse nuk e keni përmendur emrin e z. Shala në
18 dëshminë që i keni dhënë Tribunalit të Hagës. Kjo ishte pyetja
19 që ju është bërë.

20 DËSHMITARI: Unë këtë dëshmi e kam dhënë. Besoj që e kam
21 edhe të shkrume. U përmend --

22 Z. DE MINICIS: [Përkthim]

23 PY. Pyetja që bëra unë nëse mund të të kujtohet arsyeja se
24 përse emri nuk ishte në atë deklaratë. Në qoftë se nuk ju
25 kujtohet një gjë e tillë, atëherë mund të kalojmë në pyetjen

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: TW4-08 (Seancë private)

Faqe 47

Pyetje nga z. De Minicis

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F469RED dhe F541

1 tjetër.

2 PË. Emrin në këtë deklaratë, s'po di. Veç, në qoftë se ka
3 qenë edhe për të tjerët, atëherë nuk ka qenë e domosdoshme
4 ndoshta prej hetuesve, për me e cekë emrin e tij, se kanë qenë
5 pjesë të ndamë të gjykimit. Kam marrë pjesë edhe në gjykime të
6 tjera. Po them që kjo ndoshta mund të ketë qenë arsyeja.

7 PY. Faleminderit, z. Dëshmitar.

8 Po na tregonit se çfarë i ka thënë Pjetër Shala babait
9 tuaj në atë kohë.

10 Të nderuar Gjykatës, të kalojmë shkurtimisht në seancë
11 private për pyetjet vijuese pasi ashtu do t'i jetë më mirë.

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Zonja
13 sekretare, ju lutemi të kalojmë në seancë private.

14 Faleminderit.

15 [Seancë private]

16 [Seancë private teksti i fshirë]

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: TW4-08 (Seancë private)

Faqe 48

Pyetje nga z. De Minicis

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F469RED dhe F541

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8 [Seancë e hapur]

9 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Tani jemi në seancë
10 publike, të nderuar Gjykatës.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mund
12 të vazhdoni z. Sekretar [sipas përkthimit]. Del në
13 transkriptim pak më herët se sa momenti se kur është thënë.

14 Z. DE MINICIS: [Përkthim]

15 PY. Tani kemi kaluar në seancë publike prandaj të tregohemi
16 të kujdesshëm.

17 I kthehem edhe një herë incidentit kur kanë ardhur
18 njerëzit te shtëpia. E kemi diskutuar gjerësisht, çfarë ndodhi
19 kur erdhën këta njerëz. Ju thatë që atyre u keni dhënë një
20 armë. Pyetja është çfarë ndodhi më pas.

21 PË. Më pas këta kanë filluar rrugën në drejtim të Jabllanicës
22 dhe ne e kemi ditur që situata është jo aq e mirë dhe jemi
23 larguar, e gjithë familja, në drejtim të Gjakovës, dhe jemi
24 sistemuar në Gjakovë.

25 PY. Nëse ju kam kuptuar siç duhet, pas këtij incidenti, ju

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: TW4-08 (Seancë e hapur)

Faqe 50

Pyetje nga z. De Minicis

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F469RED dhe F541

1 ikët nga shtëpia ku banonit deri në maj të vitit 1998, dhe
2 shkuat e u vendosët në qytetin e Gjakovës. Kështu është?

3 PË. Po.

4 PY. Sa kohë pas kësaj vizite në shtëpinë tuaj u larguat nga
5 shtëpia juaj?

6 PË. Nga shtëpia jonë po atë ditë.

7 PY. Sa kohë qëndruat në Gjakovë pasi u vendosët atje?

8 PË. Në Gjakovë kemi qëndruar në një banesë private, ku kemi
9 paguar me të holla, dhe kemi qëndruar deri në dëbimin masiv të
10 popullatës shqiptare nga forcat serbe, për në drejtim të
11 Shqipërisë. Ka qenë fundi i marsit të vitit 1999.

12 PY. Faleminderit. Është një pyetje lidhur me incidentin e
13 mëparshëm të cilën harrova ta bëj, po i kthehem edhe një herë.
14 Në përgjigjen tuaj përpiquini të mos jepni hollësi
15 identifikuese.

16 Me sa dini, ku ishte babai kur kanë ardhur te shtëpia
17 juaj këta njerëz?

18 PË. Në shtëpi, s'e kemi lënë për të dalë jashtë dhe që të
19 bëhej më e keqja.

20 PY. Me sa e dini ju, pse po kërkonin babanë ata njerëz atë
21 ditë?

22 PË. Duhet me e ditë këtë pyetje Shtabi i Përgjithshëm, dhe me
23 urdhër të Lahi Brahimit. Ata janë drejtuesit. "Kemi urdhër nga
24 Lahi Brahimi."

25 PY. Faleminderit. Sapo na thatë që ishte nga fundi i marsit

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: TW4-08 (Seancë e hapur)

Faqe 51

Pyetje nga z. De Minicis

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F469RED dhe F541

1 të vitit 1999 kur familja u largua nga Gjakova e shkoi në
2 Shqipëri, kështu?

3 PË. Po.

4 PY. Përse vendosët të shkonit në Shqipëri nga fundi i marsit
5 të vitit 1999 vendosët të shkonit për në Shqipëri e të
6 largoheshit nga Kosova?

7 PË. Domethënë, kanë filluar bombardimet, kështu që forcat
8 serbe kanë përndjekur gjithë qytetin aty, në kolona të gjata,
9 dhe na kanë vënë në drejtim të Shqipërisë.

10 PY. Në atë kohë, a ishte babai punëtor i policisë?

11 PË. [e padëgjueshme].

12 PY. Pasi arritët në Shqipëri, ku u vendosët fillimisht?

13 PË. Fillimisht kemi arritur në Kukës, ku shoqatat humanitare
14 na kanë pritur me ujë, sende ushqimore dhe gjëra të tjera. Më
15 pas kemi filluar rrugën në drejtim të Durrësit, pasi që atje e
16 kishim një hallë të strehuar më herët. Edhe ajo për shkaqet e
17 luftës dhe përndjekjes. Është sistemuar më herët, kështu që --

18 PY. Nuk kemi deri tani ndonjë problem ose tregoni kujdes mos
19 të jepni hollësi që mund të identifikojë këtë person me anë të
20 të cilit mund të bëhet identifikimi juaj, por deri tani më
21 duket se s'kemi probleme.

22 PË. Dhe kështu që në orën 12.00 të natës kemi mbërritur në

23 [REDAKTUAR], në Durrës, ku një shqiptar nga

24 Shqipëria na ka ofruar strehim në shtëpinë e tij, po atë natë,
25 me gjithë familjen.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: TW4-08 (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F541
Pyetje nga z. De Minicis Faqe 52
Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F469RED dhe F541

1 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, a mund të
2 kalojmë shkurtimisht në seancë private.

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Zonja
4 Sekretare, ju lutemi të kalojmë në seancë private.

5 ~~[Seancë private]~~ [Seancë e hapur] Riklasifikuar në
6 bazë të F541

7 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
8 jemi në seancë private.

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
10 Faleminderit.

11 Z. DE MINICIS: [Përkthim]

12 PY. Z. Dëshmitar, kur arritët në Durrës, fillimisht ku
13 qëndroi familja juaj pasi arritët në Durrës

14 PË. Pasi mbërritëm në Durrës, familja jonë qëndroi në
15 shtëpinë e një shqiptari nga Shqipëria, [REDAKTUAR]

16 [REDAKTUAR]

17 [REDAKTUAR]

18 PY. [REDAKTUAR], a

19 qëndruat në një vend tjetër më përpara? [REDAKTUAR]

20 [REDAKTUAR]

21 [REDAKTUAR]

22 PË. Kemi qëndruar në vetura dhe aty afër në rrugë dhe jemi
23 takuar me atë person rastësisht.

24 PY. Faleminderit. E kuptojmë që ka kaluar shumë kohë që
25 atëherë, por me lejen e Trupit Gjykses, dua t'ju rifreskoj
kujtesën sa i takon në bazë të rregullës 142, paragrafi 1. Do

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: TW4-08 (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F541
Pyetje nga z. De Minicis Faqe 53
Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F469RED dhe F541

1 ju lexoj një pjesë të vogël të intervistës që keni dhënë
2 asokohe për këtë temë, në vitin 2022.

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Do ta
4 nxjerrim në ekran? Se është më mirë që jetë edhe në ekran,
5 përveçse që ta lexojmë.

6 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Patjetër.

7 Është dokumenti 105285-TR-ET, në anglisht te faqja 4.

8 Z. DE MINICIS: [Përkthim]

9 PY. Mirë, shohim rreshtat nga 2 deri në 6 në anglisht. Po
10 flasim këtu për qëndrimin tuaj në Shqipëri. Ju thatë:

11 "Po, për një javë kemi ndenjur te halla. Pas një jave ka
12 ardhur [REDAKTUAR], na ka marrë për të gjitha atje, se
13 problemet e qysh ty po nisën po ndodhin aty."

14 Prandaj ju pyeta, në qoftë se ju personalisht apo ndonjë
15 anëtar tjetër i familjes kishte qëndruar në ndonjë vend tjetër
16 para se të shkonit te shtëpia [REDAKTUAR] A ju kujtohet kjo,
17 z. dëshmitar?

18 PË. Ne -- unë e thashë që herën e parë jemi -- personin e
19 lartë cekur, që na ka mbajtur një natë. [REDAKTUAR], dhe
20 pastaj, të nesërmen kemi shkuar te halla, tuj banu.

21 [REDAKTUAR]

22 [REDAKTUAR]

23 [REDAKTUAR], ku jemi vendosur dhe deri në
24 kthimin në Kosovë kemi qëndruar aty.

25 PY. Faleminderit për sqarimin.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: TW4-08 (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F541
Pyetje nga z. De Minicis Faqe 54
Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F469RED dhe F541

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju
2 kujtoj që jemi në seancë private, z. prokuror.

3 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Besoj që është krejt OK të
4 kalojmë përsëri në seancë publike.

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
6 rregull. Z. sekretare e gjykatës, kalojmë në seancë publike.

7 ~~[Seancë e hapur]~~

8 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

9 Z. DE MINICIS: [Përkthim]

10 PY. Z. Dëshmitar, ju na treguat se si kaluat, pra, nga një
11 vend te tjetri dhe thatë:

12 "Pas disa incidenteve, pra pasi ndodhën disa incidente,
13 ne shkuam te shtëpia e këtij personi tjetër." Kjo është në
14 faqen 48, rreshtat 15 deri në 17 të transkriptimit të sotëm
15 provizor.

16 Për çfarë incidentesh e keni fjalën? A mund të na tregoni
17 diçka më shumë?

18 PË. Po. Incidentet kanë ndodhur të njëpasnjëshme aty.

19 Domethënë, me babën një person i quajtur Loçka, ku me një
20 parukë në kokë ka dashur që ta -- të na bëjë me ato ledhatimet
21 e veta, së pari, që po kërkoj një familje. A di ku është,
22 dikur i ka thënë që "hyr në veturë". Babi në atë kohë ka qenë
23 i fortë fizikisht kështu që janë kacafyt mes vete, ja ka marrë
24 revolen dhe i ka thënë që "Unë nuk vij, kush je ti. Të
25 legjitimohesh, kush je". Më pas ja ka gjuajtur revolen në

1 automjetin e tij, ku ai ka ikur me një shpejtësi.

2 Më pas, jo atë ditë --

3 Z. DE MINICIS: [Përkthim]

4 PY. Kur ndodhi ky incident asokohe, po qëndronit te shtëpia e

5 parë apo te ajo shtëpia tjetër që shkuat më mbrapa? Po rrinit

6 te halla apo te ai vendi tjetër?

7 PË. Jo, unë po flas për te halla janë këto tre incidente.

8 Janë te halla. Për një javë, sa kam qëndruar aty, një javë,

9 ashtu. Dhe më pas personi [REDAKTUAR] ka ardhur dhe na ka

10 strehuar në shtëpinë e tij në Durrës.

11 PY. Faleminderit.

12 Pasi shkuat te kjo shtëpia tjetër në Durrës, te kjo

13 banesa tjetër në Durrës, ndodhi ndonjë gjë, i ndodhi ndonjë

14 gjë familjes?

15 PË. Aty është kidnapuar babai im, ku unë kam qenë prezent dhe

16 i zoti i shtëpisë -- kemi dalë për një shëtitje në atë rrugë.

17 Aty ka ardhur një ardhur një automjet, veturë ngjyrë e kaltër,

18 Ascona, me tabela AG, ku numrat s'kam mujt t'ja mbaj mend, e

19 ajo veturë ka qenë edhe në incidentet te halla, edhe u përdor

20 edhe në incidentin kur babai im është kidnapuar nga katër

21 persona, kinse të UÇK-së. Ashtu janë prezantuar.

22 E kanë ndalur veturën në një vend shumë të përshtatshëm

23 aty ku e dinë që jemi të përcjellun. Është ndalur mes zidnave,

24 ku nuk kishte vend që të largoheshe apo t'i ikësh atij

25 problemi. Kanë dalë katër persona, të gjithë kanë dalë me armë

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: TW4-08 (Seancë e hapur)

Faqe 56

Pyetje nga z. De Minicis

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F469RED dhe F541

1 dhe kanë thënë që "dorëzohu, je i arrestuar." Babai im ju ka
2 thënë "a keni ndonjë fletë arrest zyrtar?" Kanë thënë "mbylle
3 gojën. Je i arrestum." Ne atëherë mbasandej kemi -- në
4 vetëmbrojtje, duke u kacafyt me ta. Mua pronari i shtëpisë më
5 tha që "dil thirri kushërinjtë dhe vëllaznit e mi" dhe unë kam
6 ecur rrugës përposh me shtëpinë ku kemi qenë tuj banu dhe te
7 vëllai i pronarit të shtëpisë, për të kërkuar ndihmë. Babanë
8 tim e kanë kidnapuar këta katër persona. Njëri ndër ta ka qenë
9 Bashkim Lama, ka qenë ai që ka qenë më herët në incidentet e
10 mëparshme, me parukë në krye, por kështu atë ditë ka qenë pa
11 parukë, kryet -- i kish flokët e ramë, si tullac, me
12 pseudonimin Loçka. Ata mund ta dinë Bashkim Lama. Kush janë?
13 Me urdhër të kujt kanë ardhur? Pse, nuk ka qenë diçka -- pa
14 fletë zyrtare, pa asnjë --. Domethënë, me një fjalë, kidnapim,
15 me dhunë.

16 PY. Faleminderit, z. Dëshmitar. Do t'ju bëj dy tre pyetje të
17 tjera, për të na sqaruar diçka më shumë lidhur me këtë që sapo
18 na thatë.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.
20 Prokuror, a mos do të ishte më mirë të kalonim në seancë
21 private? Se kjo varet nga pyetjet që doni të bëni, kuptohet.

22 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Domethënë pyetjet e para mund
23 t'i bëj në seancë publike dhe pastaj kalojmë në seancë
24 private.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Për

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: TW4-08 (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F541
Pyetje nga z. De Minicis Faqe 57
Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F469RED dhe F541

1 siguri, kalojmë në seancë private.

2 Z. sekretare e gjykatës, të kalojmë në seancë private, ju
3 lutem?

4 ~~{Seancë private}~~ [Seancë e hapur] Riklasifikuar në
bazë të F541

5 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë private.

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

7 Faleminderit.

8 Emri Loçka është i redaktuar te aktakuza kështu që ju
9 lutem, z. Dëshmitar në seancat publike, mos përdorni këtë
10 emrin Loçka, dhe as emrin Lama.

11 Nëse ju mendoni që s'mund t'i përgjigjeni pyetjes pa
12 përmendur këta emra, atëherë m'u drejtoni mua ose prokurorit,
13 që të kalojmë në seancë private. Mund të thoni nuk e them dot,
14 dhe pastaj mund të kalojmë në seancë private. Mirë?

15 DËSHMITARI: Mirë.

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

17 Atëherë z. sekretare e gjykatës, të kalojmë përsëri në seancë
18 publike.

19 ~~{Seancë e hapur}~~

20 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

22 Faleminderit.

23 Prokuror, fjala është për ju.

24 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar Gjykatës.

25 PY. Pra na treguat për këtë rastin ku ishit i pranishëm, ku e

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: TW4-08 (Seancë e hapur)

Faqe 58

Pyetje nga z. De Minicis

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F469RED dhe F541

1 kidnapuan babanë tuaj. Në faqen 50, rreshti 14 dhe 15 në
2 transkriptim thatë: "Kur kidnapuan katër persona babanë tim,
3 kinse nga UÇK-ja, se kështu u prezantuan".

4 Ndonjë nga grupi, a tha që ne jemi anëtarë të UÇK-së, u
5 shpreh kështu?

6 PË. Po, Bashkim Lama.

7 PY. Mirë. Mbanin uniforma -- kishin mbathur uniforma?

8 PË. Uniformat aty -- tesha të zeza, majic të zezë, komplet të
9 zezë kanë qenë, të katërt.

10 PY. Sa larg ishe ti nga ky grup personash teksa po
11 zhvilloheshin këto ngjarje?

12 PË. Në grup, tuj -- tuj jap rezistencë.

13 PY. Pra, kishit kontakt fizik me ta?

14 PË. [e padëgjueshme].

15 PY. A dallove, a kishin ndonjë emblemë?

16 PË. Po, në atë momente unë -- një person e njohja.

17 PY. Mos e themi emrin, të lutem -- emrin.

18 PË. Një person e njihja, por aty nuk më kujtohet diçka kështu
19 -- por e di që u prezantuan me "Policia. Je arrestuar, je [e
20 pakuptueshme]". Kësi sendesh.

21 PY. Po, ata u prezantuan si të policisë apo si të UÇK-së, që
22 ta kuptoj unë?

23 PË. Policia e UÇK-së.

24 PY. Faleminderit. Vetëm për ta sqaruar dhe këtë. Nga personat

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: TW4-08 (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F541
Pyetje nga z. De Minicis Page 59
Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F469RED dhe F541

1 që u përfshinë në këtë incident -- pra ndonjë nga këta
2 personat e përfshirë në këtë incident, a ishte përfshirë në
3 ndonjë nga ato tentativat e mëparshme që përmende. Pikërisht
4 ato tentativat që ju bënë që ju të iknit nga shtëpia. Pra,
5 ndonjë nga këta persona, a ishte i përfshirë edhe në ato
6 tentativat e mëparshme?

7 PË. Po.

8 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, a mund të
9 kalojmë në seancë private, shkurtimisht?

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju
11 lutem të kalojmë në seancë private.

12 ~~{Seancë private}~~ [Seancë e hapur] Riklasifikuar në
bazë të F541

13 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë private.

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

15 Faleminderit.

16 Prokuror, vazhdoni.

17 Z. DE MINICIS: [Përkthim]

18 PY. Tani jemi në seancë private. A mund të na thoni cili nga
19 këta të katërt personat që u përfshinë në incidentin që sapo
20 na treguat kishte qenë i përfshirë edhe në incidentin e
21 mëparshëm, pra që kërkonte për babanë tuaj gjatë kohës që ju
22 ishit në Shqipëri?

23 PË. Babanë tim e -- ka qenë Loçka dhe, në të vëllait tim, që
24 e kanë kidnapuar për një orë deri sa i kanë thënë "deri sa të
25 vijë babai ti je i kidnapuar". E kanë marrë vëllain tim, dhe e

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: TW4-08 (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F541
Pyetje nga z. De Minicis Faqe 60
Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F469RED dhe F541

1 kanë mbajtur në busa, në kerr, "deri sa të vijë babai yt, ti
2 je i kidnapum". Aty te busa, vëllai im e ka parë Bashkim
3 Lamën, prezent. Kjo ka ndodhur te halla, në incidentet e para.
4 PY. Për cilin nga vëllezërit e ke fjalën, cili nga vëllezërit
5 mbajtën në një bus këta?

6 PË. [REDAKTUAR]

7 PY. E mbani mend pak a shumë sa kohë pas mbërritjes në
8 Shqipëri ndodhi kjo?

9 PË. Kjo ka ndodhur -- një natë kemi qëndruar te ai
10 [REDAKTUAR]. Javën tjetër, si kemi ardhur te halla, një ditë a
11 dy dhe kanë ndodhur këto incidentet. Te halla, për ato ditë sa
12 kemi qëndruar te halla.

13 PY. Do t'i kthehem shkurtimisht kohës kur udhëtuat nga Kosova
14 drejt Shqipërisë, asaj periudhe. Familjen tuaj, a e ndaloi
15 ndokush rrugës, nga Kosova drejt Shqipërisë?

16 PË. Prej Kosove deri në Shqipëri po e kanë ndal dhe ata janë
17 prezantuar si policistë të UÇK-së, në qytetin Laç të
18 Shqipërisë, mirëpo aty na ka legjitimuar policia shqiptare, me
19 dokumentacione, me sende, ku po shkoni, e kështu, kështu,
20 kështu, dhe na kanë liruar.

21 PY. Faleminderit. Tani, prapë për periudhën kur ndodhi
22 kidnapimi. Ka kaluar shumë kohë, po a ju kujtohet me saktësi
23 data kur ndodhi ky incident?

24 PË. [REDAKTUAR]

25 [REDAKTUAR]

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: TW4-08 (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F541
Pyetje nga z. De Minicis Faqe 61
Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F469RED dhe F541

- 1 [REDAKTUAR] Kemi dalë për shëtitje, siç ceka edhe një herë,
2 me bashkëpronarin e shtëpisë dhe jemi takuar me këtë automjet
3 - Opel Ascona, ngjyrë e kaltër metalike, me tabela AG, të
4 Zvicrës.
- 5 PY. Faleminderit. Për procesverbal, po flasim për majin e
6 vitit 1999, apo jo?
- 7 PË. 1999.
- 8 PY. Ky grupi i personave, a ja doli mbanë? Kur themi a ja
9 doli mbanë, a arriti ta kidnaponte babanë tuaj me atë datë, të
10 themi [REDAKTUAR] maj të vitit 1999? E kidnapuan?
- 11 PË. Po, e kidnapuan.
- 12 PY. Çfarë bëtë ju pasi ky grupi i personave e kidnapuan
13 babanë tuaj?
- 14 PË. Unë menjëherë shkova në stacionin e policisë në Shqipëri,
15 e lajmërova rastin, më pas kam shkuar në qendrat e OSBE-së, të
16 USAID-it dhe organizatave të tjera që kanë qenë me degë në
17 Shqipëri.
- 18 PË. A shkuat vetëm apo me ndonjë person tjetër që ta
19 raportoni rastin në polici?
- 20 PË. Me pronarin e shtëpisë.
- 21 PY. Sa kohë pasi e kidnapuan babanë shkuat dhe e raportuat
22 rastin në polici?
- 23 PË. Menjëherë.
- 24 PY. Bëri ndonjë gjë policia menjëherë pasi e raportuat ju
25 rastin e kidnapimit?

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: TW4-08 (Seancë private)

Faqe 62

Pyetje nga z. De Minicis

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F469RED dhe F541

1 PË. Na i mori deklaratat, asi. Ka kyçur -- se unë isha aty
2 prezent në zyrë duke dhënë deklaratën, ka folur me patrullat
3 në terren, i dëgjoja aty duke komunikuar me radiolidhje, po
4 asgjë. Domethënë, rezultate s'ka pasur.

[Seancë private]

5 [Seancë private teksti i fshirë]

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

[Seancë e hapur]

18 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Fjala
20 për ju, prokuror.

21 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

22 PY. Mirë. Ju na treguat si e kidnapuan babanë tuaj dhe që ju
23 e raportuat rastin në polici. Po pas asaj dite, e patë më
24 babanë tuaj?

25 PË. Jo. Babanë tim e kemi parë dikur për 13 ditë më pas, diku

1 nga fillimi i prillit, që është liruar [REDAKTUAR]

2 [REDAKTUAR]

3 [REDAKTUAR]

4 [REDAKTUAR]

5 PY. Për ta sqaruar, më duket se thatë u lirua në fillim të
6 prillit, po ju thatë u kidnapua në mes të majit.

7 PË. Më falni, në fillim të qershorit.

8 PY. Faleminderit, ma mori mendja që ishte një gabim. Qëparë
9 përsëri na thatë që [REDAKTUAR]

10 [REDAKTUAR] ku e

11 sollën pas lirimit babanë tuaj?

12 PË. Babanë tim e sollën në [REDAKTUAR]

13 PY. Faleminderit. Ju ishit i pranishëm? Pra a ishit i
14 pranishëm kur ua sollën babanë?

15 PË. [e padëgjueshme].

16 PY. Dhe ndenji 13 i larguar apo jo?

17 PË. Ashtu.

18 PY. Në ç'kushte ishte babai kur ua sollën?

19 PË. Babai im kur e kanë sjellë ka qenë në kushte tërësisht jo
20 njerëzore. Kundërmonte erë të keqe. Domethënë, mos -

21 papastërri. Dhunë në kokë, bërrylin e dorës së majtë --

22 domethënë në peshë dhe kur ka hyrë brenda i kemi parë edhe

23 sende të tjera, djegie me cigare në gjoksin e tij. Shihej që

24 është bërë një dhunë brutale nga qenia njerëzore.

25 PY. Ju vetë personalisht i patë këto shenja që po na

1 përshkruani tani?

2 PË. Të gjitha këto i kam parë personalisht.

3 PY. A patë ndonjë ndryshim tjetër në paraqitjen e babait tuaj
4 përveç këtyre që sapo na përshkruat?

5 PË. Ndryshimi ishte në fizikun e tij, ai -- rënien në peshë.

6 PY. Faleminderit. Tani, këto që diskutuam tani janë gjëra që
7 ju keni parë vetë, pasi u kthye babai pas këtyre 13 ditëve.

8 Pra, na treguat çfarë ju patë vetë personalisht. Dhe dua t'ju
9 pyesja, kush ishte tjetër i pranishëm bashkë me ju kur u kthye
10 babai?

11 PË. E gjithë familja, përveç një vëllai jonë, që ka qenë në
12 Kosovë.

13 PY. Pasi vutë re ndryshimet në pamjen e babait tuaj pasi u
14 kthye, unë desha t'ju pyes nëse ju tregoi ndonjëherë babai,
15 qoftë ju apo pjesëtarëve të tjerë të familjes, a i tregoi
16 ndonjë nga gjërat që i kishte ndodhur gjatë këtyre 13 ditëve?
17 Babai, ju tregoi në ndonjë moment çfarë i kishte ndodhur?

18 PË. Po.

19 PY. Sa kohë pas kthimit ka filluar t'ju tregojë këto gjëra?

20 PË. Pak të nesërmen, besa ja ka nisë pak, se aty kur e prunë
21 shërbimi sekret, domethënë gjendja e tij ka qenë e
22 tmerrueshme. Ne s'kishte çfarë të na tregonte. Ne e shihni atë
23 vetë. Të gjitha i kemi parë vetë. Po të nesërmen kanë filluar
24 bisedat, kohë pas kohe. Nga pak, ka tregua për tmerrin që ka
25 kaluar atje. Dy ditë është mbajtur në qendrën Ramallak dhe pas

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: TW4-08 (Seancë e hapur)

Faqe 65

Pyetje nga z. De Minicis

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F469RED dhe F541

1 dy ditëve e kanë dërguar në Kukës, Cahan, në fabrikën e
2 metaleve, ku aty është bërë një dhunë që ndaj një njeriu nuk
3 bëhet ashtu, jo veç ndaj babait tim, por të gjithë të
4 burgosurve të tjerë që i kanë mbajtur aty.

5 PY. Thatë që pas rrëmbimit, babai u dërgua në një vend që ju
6 thatë që quhet Ramallak dhe më pas e kanë dërguar në Kukës.
7 Kështu është?

8 PË. [e padëgjueshme].

9 PY. Ju përshkruat në përgjithësi gjendjen e tij dhe përmendët
10 të gjithë të ndaluarit e tjerë atje. Pyetja ime është si e
11 keni ditur që ka pasur njerëz të tjerë atje. A ju ka treguar
12 babai që bashkë me të kanë qenë të ndaluar edhe persona të
13 tjerë në atë kohë?

14 PË. Po.

15 PY. Dhe këtu e ke fjalën për Ramallakun apo për Kukësin?

16 PË. E kam fjalën për Kukësin, por edhe në Ramallak ka pasur.
17 Domethënë, se baba kur ka shkuar për Kukës, e kanë -- me katër
18 persona ka shkuar. Me të burgosur. Vetë i katërt ka qenë,
19 kështu sipas babës.

20 PY. Faleminderit. A ju kujtohet sipas asaj që ju a ka treguar
21 babai për ndalimin në Kukës, a ju ka tregua emrin e ndonjë
22 prej personave që e kanë mbajtur të ndaluar atje? A ju ka
23 përmendur, pra ndonjë emër?

24 PË. Po.

25 PY. A të kujtohen emrat e personave --

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: TW4-08 (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F541
Pyetje nga z. De Minicis Faqe 66
Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F469RED dhe F541

1 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, ndoshta
2 mund të kalojmë në seancë private përpara se të vazhdoj me
3 këtë pyetje.

4 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj.
5 Sekretare, mund të kalojmë në seancë private?

6 ~~{Seancë private}~~[Seancë e hapur] Riklasifikuar në
7 bazë të F541

8 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Kemi kaluar në seancë
9 private, të nderuar Gjykatës.

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
11 Faleminderit.

12 Z. Prokuror, mund të vazhdoni.

13 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Z. Dëshmitar, tani jemi në
14 seancë private.

15 PY. Çfarë emrash apo hollish të kujtohen sot? E di që ka
16 kaluar shumë kohë, por çfarë emrash të kujtohen që të ketë
17 treguar babai lidhur me personat që kanë qenë të ndaluar me

18 PË. Në lidhje me personat që kanë qenë të ndaluar, domethënë,
19 janë Sabit Geci, Xhemshit Krasniqi dhe Pjetër Shala.

20 PY. Po e bëj pyetjen pak më të saktë.

21 Pak më herët na treguat që aty kishte të ndaluar të
22 tjerë, si babai yt që ishin të ndaluar atje. Këta persona që
23 sapo i përmendët, a ishin persona të ndaluar bashkë me babanë
24 tënd? A ishin ata të burgosur?

25 PË. [e padëgjueshme].

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: TW4-08 (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F541
Pyetje nga z. De Minicis Page 67
Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F469RED dhe F541

1 PY. Babai yt është rrëmbyer dhe është privuar nga liria, në
2 faqen 59 të dëshmisë suaj, transkriptimi jo përfundimtar,
3 rreshtat 13 deri në 15, dhe thatë:

4 "Është ushtruar dhunë të cilën nuk mund ta bësh asnjëherë
5 kundër një qenie njerëzore. Jo vetëm kundër babait tim, por
6 edhe kundër asnjë prej të burgosuri, si ata që janë mbajtur
7 atje" dhe pyetje ime është: kush janë personat që keni
8 përmendur këtu kur thoni "të gjithë të ndaluarit, që janë
9 mbajtur të ndaluar atje". Pra personat të cilët si babai yt,
10 ishin të ndaluar, pra persona të ndaluar. A të ka treguar
11 babai se kush kanë qenë këta persona? Të ka treguar emrat e
12 ndonjërit prej tyre?

13 PË. [e padëgjueshme].

14 PY. A të kujtohen emrat edhe sot e kësaj dite?

15 PË. Diku kanë qenë të ndaluar atje, diku për afërsisht dhjetë
16 vetë. Çka babai im ka mujt t'i shohë. Tetë deri në dhjetë.

17 [REDAKTUAR]

18 [REDAKTUAR]

19 [REDAKTUAR]

20 PY. Faleminderit.

21 Na dhatë një përshkrim të përgjithshëm të trajtimit që i
22 kanë bërë babait. Ky në faqen 59. Na thatë se si filloi të
23 fliste të nesërmen për gjërat e tmerrshme që i kishte
24 përjetuar atje.

25 A të kujtohen hollësi të tjera lidhur me këto gjëra të

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: TW4-08 (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F541
Pyetje nga z. De Minicis Page 68
Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F469RED dhe F541

1 tmerrshme që i kanë ndodhur babait në atë kohë, në atë vend?

2 PË. Sipas babait, të gjithë njerëzit që kanë qenë aty, janë
3 rrahur në mënyrë brutale. Domethënë, i kanë zgjuar edhe nga
4 gjumi natën dhe i kanë rrahur. Me mjete. Bejsbolli --

5 PY. Kërkoj ndjesë që po ju ndërpres.

6 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, mund të
7 kalojmë në seancë publike tani që kemi bërë identifikimin e
8 personave, pra dhe pjesën tjetër mund ta bëjmë në seancë
9 publike.

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po,
11 faleminderit.

12 Z. dëshmitar, kujdes që të mos përmendi emrat që sapo i
13 keni përmendur në seancën private. Mund të bëni përshkrim, por
14 jo të thoni emrat.

15 Znj. Sekretare, ju lutem të kalojmë në seancë publike.

16 ~~{Seancë e hapur}~~

17 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike
18 tani.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
20 Faleminderit.

21 Z. Prokuror, ju e keni fjalën.

22 Z. DE MINICIS: [Përkthim]

23 PY. Ju kërkoj ndjesë, Dëshmitar, për ndërprerjen. Po është
24 kjo e rëndësishme që do të thuhet në seancë publike.

25 Po e përsëris pyetjen që kam bërë. A të kujtohen hollësi

1 të tjera lidhur me keqtrajtimin që ka përjetuar ai në atë kohë
2 në fabrikën e metalit në Kukës?

3 PË. Po. Është goditur në kokë me revolver, është djegur me
4 cigare, ku cigaret janë shujtur në trupin e tij, elektroshok.
5 Bejsboll, mjete të forta.

6 PY. A të ka treguar nëse kjo ka ndodhur një herë, dy herë,
7 shumë herë?

8 PË. Kjo ka ndodhur deri sa një ditë kur ka ardhur në shtëpi
9 që e kanë prurë njerëzit të cilët i ceka më herët -- kjo ka
10 ndodhur gjatë tërë kohës sa ka ndenjtur në vendin e burgut
11 improvizues.

12 PY. Gjatë kësaj kohe, kur ishte në Kukës, a e kanë marrë në
13 pyetje babanë?

14 PË. Se - pyetje, dy tre fjalë: "I ke vrarë 100 persona, ke
15 dhunu, ke ...", pyetje të cilat e dinë ata. Dhe dhunë,
16 "nënshkruaje, prano që i ke vrarë 100 persona". Babai im i ka
17 thënë: "qitni vetëm një, të tjerat i pranoj unë". Duke dashur
18 që të nënshkruante me dhunë një diçka që s'e ka bërë.

19 PY. Para disa sekondave, na thatë dhe tani do t'i përsërisim
20 në seancë publike, na thatë pra emrat e disa personave të
21 cilët ishin të ndaluar me babanë tuaj. A ka përmendur
22 ndonjëherë babai juaj emrat e këtyre personave të cilët e kanë
23 ushtruar këtë dhunë dhe kanë bërë këto pyetje?

24 PË. Po.

25 PY. A të kujtohen këto emra?

1 PË. Po. Sabit Geci, Xhemshit Krasniqi, Pjeter Shala, me
2 njerëz të tjerë që s'ja u ka ditur emrat.

3 Z. AOUINI: [Përkthim] Ju kërkoh ndjesë.

4 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] E
5 shoh po përpara do të zgjidhim çështje tjetër.

6 Z. Avokat, përpara se ta merrni fjalën, është diçka për
7 të cilën kërkohet që të dalë nga salla dëshmitari?

8 Z. AOUINI: [Përkthim] Jo, s'ka nevojë, të nderuar
9 Gjykatës.

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] E
11 keni fjalën.

12 Z. AOUINI: [Përkthim] Një sqarim lidhur me incidentin për
13 të cilin po bisedohet në këtë seri pyetjesh. Ju kërkohet
14 dëshmitarit që të paraqesë burimin e informacionit por nuk
15 është këtu në këtë procesverbal. Ne nuk e kemi informacionin -
16 - e kemi të vështirë të bëjmë pyetje kur nuk e kemi burimin e
17 informacionit. Nga ku vjen informacioni? A është kjo njohuri
18 personale? Janë një numër pyetjesh dhe përgjigjesh por burimi
19 i informacionit nuk është e qartë dhe kjo pyetje dhe përgjigja
20 e fundit është një shembull ilustrues i së kundërtës.

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
22 Faleminderit.

23 Nuk jam e sigurt se cila është pyetja juaj. Cila është
24 pyetja juaj konkrete që keni në këtë rast?

25 Z. AOUINI: [Përkthim] A mund të na jepet burimi i

1 informacionit?

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Për
3 mua është e qartë se cili është burimi i informacionit.
4 Pavarësisht se nuk po flasim për burimin, por po kërkoj që të
5 dali së pari nga salla dëshmitari, dhe pastaj të jap
6 përgjigjen tuaj, me qëllim që të mos ndikohet ai në përgjigjejt
7 e tij.

8 Z. Dëshmitar, do t'ju kërkojmë të largoheni nga salla e
9 gjyqit për dy tre minuta, sa të bëjmë një diskutim.

10 Sekretaria do t'ju tregojë rrugën.

11 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po i
13 jap fjalën Prokurorit t'i japë përgjigje pyetjes suaj.

14 Z. AOUINI: [Përkthim] A mund ta përfundoj, me qëllim që
15 të mos keqkuptohemi, ju kërkoj ndjesë.

16 Pra kemi një rrëfim por nuk dimë se kush po ja tregon
17 këtë dëshmitarit. Thuhet që kjo ka ndodhur por pyetje dhe
18 përgjigja e fundit është - aty bëhet fjalë për tre persona të
19 ndaluar dhe pastaj për personat kryes.

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] A
21 mund të tregoni për cilat rreshta bëhet fjalë? Por e thënë
22 thjesht, burimi i informacionit është babai, kështu e kam unë
23 deri më tani. Nuk ka ndryshuar ndonjë gjë.

24 Prokurori ka pyetur "çfarë tjetër ju ka treguar babai?".

25 Prokuror, ju e keni fjalën.

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F469RED dhe F541

1 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Po, e nderuar Gjykatëse, në
2 fund të faqes 58 dhe fillimit të faqes 59 të transkriptimit jo
3 përfundimtar, i kërkova dëshmitarit nëse babai ju ka treguar
4 ju apo ndonjë anëtar tjetër të familjes ndonjë gjë që i ka
5 ndodhur atij gjatë këtyre 13 ditëve. Dhe më herët bëra
6 dallimin midis gjërave që ai kishte parë dhe gjërave që kishte
7 mësuar nga babai i tij.

8 Pra, konkluzioni sipas meje ishte që bëhej fjalë për një
9 ngjarje që e ka mësuar nga babai i tij, të cilin ka filluar ta
10 dëgjojë një ditë pasi ai është sjellë në shtëpi. Nuk di se për
11 çfarë burimi tjetër bëhet fjalë.

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.
13 Avokat, a e sqaron kjo pyetje, a po e zgjidh shqetësimin që
14 kishit ju?

15 Z. AOUINI: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar Gjykatës.

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
17 Faleminderit.

18 Jeni ende në këmbë? Dakord, faleminderit.

19 Zonja Sekretare është larguar nga salla jonë. Shoh që po
20 e telefononi.

21 [Dëshmitari vijon dëshminë]

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Uluni
23 ju lutem.

24 Mirë se vini edhe një herë z. Dëshmitar. Faleminderit për
25 durimin që tregoni. Kemi edhe 10 minuta në orën 13.00 do të

1 marrim pushimin.

2 Tani e ka fjalën përsëri z. Prokuror për të vazhduar
3 pyetjet e tij.

4 Z. Prokuror, ju e keni fjalën.

5 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Faleminderit, e nderuar
6 Gjykatëse.

7 PY. Z. Dëshmitar, më parë kur po flisnim për kohën kur në
8 shtëpinë tuaj, kur në vitin 1998 erdhi UÇK-ja te shtëpia juaj,
9 unë të pyeta se si e dije që mes atyre njerëzve ishte edhe
10 Pjetër Shala. Dhe ju na thatë që në Kukës Pjetër Shala -- të
11 nderuar Gjykatës, do ju jap referencën se ku është përmendur
12 kjo gjë, na thatë që Pjetër Shala vetë ka thënë që "isha
13 unë... përse nuk dole atëherë kur erdhëm e të kërkonim?"
14 Pjetër Shala a i ka thënë babait tuaj, përgjithshëm anë këtë
15 periudhë kur ishte i ndaluar në Kukës në vitin 1999?

16 PË. [e padëgjueshme].

17 PY. A ta ka treguar këtë vetë babai?

18 PË. Vetë babai.

19 PY. A je i sigurt për këtë?

20 PË. Njëqind për qind.

21 PY. Faleminderit.

22 Z. Dëshmitar, kemi diskutuar kidnapimin e babait tuaj, na
23 ke treguar se në ç'gjendje ishte kur u kthye dhe pastaj na ke
24 treguar se çfarë të ka treguar pas kthimit të tij. Tani dua të
25 diskutoj një çështje tjetër dhe po i afrohem fundit të

1 pyetjeve të mia.

2 Si ka ndikuar kjo ngjarje mbi familjen tuaj?

3 PË. Keq. Shumë keq.

4 PY. A mund të jepni hollësi të tjera për ta ndihmuar Trupin
5 Gjykues? Mund të mos jetë e lehtë por me sa keni mundësi, a
6 mund të jepni hollësi?

7 PË. Po. Ka qenë emocionuese, shqetësuese. Rrugëtimi për tutje
8 në jetë. Të gjitha, domethënë, kanë qenë keq. Atëherë sëmundja
9 e babait. Dhe deri në ditën kur ka vdekur, çdo ka qenë e keqe.

10 PY. Na treguat për lëndimet fizike që ka pësuar babai dhe të
11 cilat i keni parë vetë me sytë tuaja, pra për lëndimet gjatë
12 ndalimit në Kukës. Si djali i tij, a keni vërejtur nëse ishte
13 vrarë edhe shpirtërisht, psikologjikisht nga kjo përvojë?

14 PË. Po, jo vetëm ai, por gjithë familja. Po, e gjithë
15 familja.

16 PY. Faleminderit, faleminderit shumë, z. Dëshmitar.

17 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, e shoh që
18 ora është 12.55. Jemi afër pushimit. A mund ta marrim pushimin
19 tani që të kemi mundësi të bisedojmë me dëshmitarët gjatë
20 pushimit për të parë nëse ka pyetje të tjera për t'i bërë
21 këtij dëshmitari?

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

23 Faleminderit, z. Prokuror. A mund të na tregoni edhe sa kohë
24 do ju nevojitet pas përfundimit të pushimit?

25 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, jo më

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Çështje procedurale (Seancë e hapur)

Faqe 75

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F469RED dhe F541

1 shumë se 10 minuta, besoj. 15 maksimumi.

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

3 Faleminderit. Atëherë do të marrim pushimin tani. Një orë --
4 pushim prej një ore. Takohemi në orën 14.00.

5 Zonja Sekretare, a mundeni ta shoqëroni dëshmitarin?

6 Z. Dëshmitar, tani do të marrim një pushim prej një ore.
7 Do të kthehemi përsëri në orën 14.00 dhe do të vazhdojmë me
8 pyetjet nga Zyra e Prokurorit të Specializuar për një periudhë
9 të shkurtër. Më pas do t'ja jap fjalën Mbrojtësit të
10 Viktimave. Dhe sot besoj se do të fillojmë edhe kundër pyetjet
11 nga pala e Mbrojtjes.

12 Pra këtë do të bëjmë sot pasdite. Ju uroj një pushim të
13 këndshëm gjatë drekës. Pushoni pak. Shihemi pak më vonë.

14 DËSHMITARI: Si të thoni juve. I gatshëm jam për të
15 gjitha.

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
17 Faleminderit.

18 --- Pushimi i drekës fillon në orën 12.57

19 --- Seanca rifillon në orën 14.04

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë
21 se u kthyet.

22 Ekipet a janë njësoj? ZPS-ja jeni i njëjti ekip?

23 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Po.

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
25 Mbrojtësja e Viktimave, po ashtu?

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F469RED dhe F541

1 Z. GILISSEN: [Përkthim] Jemi i njëjti ekip.

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

3 Faleminderit.

4 Para se të sjellim dëshmitarin dua te diskutoj dy gjëra.

5 Një syresh lidhur me seancat publike dhe private.

6 Diskutuam mes veti, ne Trupi Gjykues dhe mendoj që është më
7 mirë, që të bëjmë vetëm seanca publike nëse mendojmë që s'ka
8 asnjë rrezik. E kuptojmë që kriteri është pak i gjerë, pak i
9 përgjithshëm mbase po kemi bërë shumë redaktime të
10 transkriptit sot dhe duhet që të sigurohemi të mos humbasim
11 informacion.

12 Prandaj në qoftë se është e nevojshme, më mirë të kalojmë
13 në seanca private. E kuptoj që ne përgjithësisht duam që
14 seancat t'i kemi publike, po për shkak të redaktimeve të mëdha
15 që kemi bërë duhet të zgjedhim tjetër qasje. Por nëse mund të
16 jemi në seancë publike atëherë ju lutem bëje në seancë
17 publike.

18 Ndërkohë për kundërpyetjet do preferoja seancat private
19 në vend që të kemi ndërhyrje te vazhdueshme, sepse e kuptoj që
20 edhe për dëshmitarin është e vështirë ta kuptojë kur është
21 seancë publike e kur është seancë private. Pra qasje pak më
22 ndryshe kjo.

23 Do vazhdojmë me pyetje të ZPS-së dhe ndërkohë mora një
24 njoftim që Mbrojtja do të propozojë një material tjetër për ta
25 shtuar në listë që do të përdoret për t'i drejtuar pyetje

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F469RED dhe F541

1 dëshmitarit, qartë? Kështu? Para se të fillojmë me pyetjet dua
2 të diskutoj me ju për çfarë është ky material. Do t'ju jap
3 fjalën që të na jepni dhe arsyet për këtë materialin tjetër që
4 dëshironi t'i shtoni listës.

5 Dhe pastaj do t'ia jap fjalën ZPS-së dhe Mbrojtësit të
6 Viktimave për të na dhënë pikëpamjet e tyre.

7 Z. GILISSEN: [Përkthim] Unë po them që dëshmitari ka bërë
8 një gabim të madh sot për elektroshokun kur tha që ka pasur,
9 që i është kryer elektroshok. Në deklaratë duam të përdorim në
10 qoftë se është e nevojshme, është deklarata e babait. Babai ka
11 shpjeguar shumë mirë kur u bë kjo përcjellja e rrymës edhe nuk
12 ka qenë, nuk e ka bërë z. Shala këtë. Prandaj unë dua që ta
13 sqarojmë sepse ka qenë një gabim, sepse nëse lexojmë dosjen e
14 kuptojmë shumë mirë që ka ndodhur një gabim. Unë po them që
15 për hir të vërtetës duhet ta korrigjojmë këtë gabim.

16 Faleminderit.

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
18 Informacioni është ndarë me Zyrën e Prokurorit të Specializuar
19 dhe Mbrojtësin e Viktimave. A është kështu? E kam kuptuar
20 qartë? Numri i dokumentit.

21 Z. GILISSEN: [Përkthim] Po, e nderuar Gjykatëse. E kemi
22 ndarë këtë informacion.

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
24 rregull atëherë.

25 Z. Prokuror apo ndonjë prej kolegëve, ju lutem doni t'i

1 përgjigjeni?

2 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Më duhet të pranoj se ende s'e
3 kam nxjerrë dokumentin sepse kuptova që erdhi njoftimi kur
4 hyra në sallën e gjyqit dhe kemi pasur vështirësi të hymë në
5 Legal Workflow. Do të bëjmë të pamundurën ta shohim dhe pasi
6 të mbarojmë pjesën e pyetjeve do ta trajtoj edhe këtë. Do i
7 kushtoj pesë minuta gjatë kohës që Mbrojtësi i Viktimave i bën
8 pyetje dëshmitarit, mund ta shoh për çfarë është në mënyrë,
9 pra, që të bëj parashtrimet përkatëse.

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
11 rregull. Në qoftë se është nevoja mund të bëjmë edhe pesë
12 minuta pushim. E di që s'është e thjeshtë por mund t'ju japim
13 pak kohë.

14 E njëjta gjë edhe për Mbrojtësin e Viktimave, do ju
15 kërkoja të jepnit mendimin tuaj. Nëse ju nevojitet edhe ju
16 kohë, ju lutem më bëni me dije.

17 Z. LAWS: [Përkthim] Faleminderit.

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
19 rregull atëherë.

20 Znj. Asistente e Gjykatës, ju lutem të sillni
21 dëshmitarin.

22 [Dëshmitari vijon dëshminë]

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë
24 se u kthyet. Ju lutem uluni.

25 A më dëgjoni?

1 DËSHMITARI: Po.

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë.

3 Mirë se u kthyet. Tani do të vazhdojmë me pyetjet nga ana
4 e Prokurorisë dhe do t'ia jap fjalën z. Prokuror për të vijuar
5 më tej.

6 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Mirëdita z. Dëshmitar. Pak
7 pyetje më kanë ngelur.

8 Të nderuar Gjykatës, besoj se këto pyetje mund t'i
9 drejtoj në seancë publike.

10 PY. Në faqen 58, rreshtat 6 deri në 14 të transkriptit të
11 sotshëm, është një pjesë që ka lidhje me dëshminë tuaj sot
12 paradite, ju folët për kushtet e babait, gjendjen e babait kur
13 u kthye, pra kur ua kthyen në vendin apo në banesën ku po
14 qëndronte familja edhe përmendët disa kushte apo disa lëndime,
15 thatë që kishte plagë në kokë, nuk ishte larë, nuk ishte i
16 pastër, kishte të djegura në kraharor. A ju kujtohet ndonjë
17 hollësi tjetër për kushtet dhe gjendjen e përgjithshme të
18 babait kur u kthye pasi e liruan krahas këtyre që sapo na
19 thatë? A ju kujtohet ndonjë gjë tjetër?

20 PË. Po, i papastër. Gjaku i terrun nëpër ballë, në kokë.

21 PY. Faleminderit. Kjo ishte pyetja e parë. Pyetja e dytë
22 lidhet me atë që i thatë Trupit Gjykues, pra sesi ua përshkroi
23 babai disa nga maltrajtimet që kishte përjetuar ne fabrikën e
24 metalit në Kukës. A ju tha ndonjë gjë për kushtet ku i kishin
25 mbajtur? Pra vendi ku kishin fjetur, ushqimi që u kishin

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: TW408 (Seancë e hapur)

Faqe 80

Pyetje nga z. De Minicis

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F469RED dhe F541

1 dhënë, këto lloj informacionesh, kushtet e ambientit ku
2 qëndroi i ndau me familjen?

3 PË. Po, ka qenë dhomë me tri dritare, vetëm hekra, dritaret,
4 vetëm hekra, pa xhama domethënë. Dhe dhoma ka qenë beton. Disa
5 tha flejshin tha në beton, disa në sfungjera të fjetjes,
6 domethënë pa pastrim, të gjithë aty kanë nejt.

7 PY. Faleminderit.

8 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Ja sa të diskutoj diçka me
9 kolegët shkurtimisht, një moment.

10 [Prokurori i Specializuar këshillohet]

11 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, nuk kemi
12 më pyetje për këtë dëshmitar. Kjo mbaron pjesën e pyetjeve
13 tona.

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
15 Faleminderit, z. Prokuror.

16 Përpara se të vazhdojmë me pyetjet nga Mbrojtësi i
17 Viktimave, unë kam një pyetje për ju, që dua t'ju drejtoj
18 tani. Gjatë incidentit që na thatë më herët, pra ai incidenti
19 ku ishte një person me një kështu pajisje apo armë që
20 shkatërronte ndërtesa, me një armë që shkatërronte ndërtesa -
21 ky personi që thatë ju dhe që dëgjuat më vonë se e kishte
22 emrin z. Shala - ju vetë asokohe, në atë kohë e patë këtë
23 person?

24 DËSHMITARI: Po.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Dhe

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F469RED dhe F541

1 pas kaq shumë vitesh, jeni edhe në gjendje ta përshkruani? Si
2 ishte, si dukej atëherë?

3 DËSHMITARI: Personi ka qenë larg, mirëpo atë armën e
4 minahedhësit e kom pa që ka qenë personi i parë afër dyerve të
5 shtëpisë.

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po na
7 e përshkruani dot personin? Si ngjante?

8 DËSHMITARI: Personin në atë kohë e kom pa vetëm - se kanë
9 qenë pas gardhit domethënë vetëm kokat kështu, po dora mbi
10 gardh. Domethënë arma e gatshme për qitje.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Pra,
12 si e kuptoj unë ju po thoni që shihja që kishte një person po
13 për shkak se ishte larg e ke te vështirë të na e përshkruash
14 më në hollësi apo të na japësh ndonjë hollësi për personin,
15 kështu?

16 Mirë. Kaq kisha. Të bëj dhe një pyetje tjetër pak më
17 vonë, po për momentin këtë kisha. Faleminderit.

18 Mbrojtësi i Viktimave, është radha juaj për t'i bërë
19 pyetje dëshmitarit.

20 Z. LAWS: [Përkthim] Faleminderit.

21 Pyetje nga Mbrojtësi i Viktimave:

22 PY. Mirëdita z. Dëshmitar. Sikurse e dini, roli im në këtë
23 çështje gjyqësore është roli i Mbrojtësit të Viktimave. Unë
24 thjesht dua të sqaroj një aspekt me ju. Sa kohë ishte oficer
25 policie babai? Për sa kohë ishte oficer policie?

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F469RED dhe F541

1 PË. Për 35 vite. Domethënë deri në vitin 1997.

2 PY. Po.

3 Z. LAWS: [Përkthim] Ju pyeta sepse në faqen 23, rreshti 8
4 i transkriptit, thuhet diku se ishte oficer policie nga viti
5 1990 deri në 1997. Pra duket sikur ka një gabim këtu. Pra s'ka
6 qenë 7 vjet oficer policie, ka qenë pothuajse gjithë jetën.
7 Gjithë karriera e tij ka qenë e tillë në forcat e policisë,
8 apo jo?

9 PË. Gjithë karriera e tij ka qenë në forcat e policisë prej
10 moshës rinore, në moshën njëzet e...

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
12 Ndjesë. Mbrojtësi i Viktimave, ju lutem kur nuk i bëni pyetje
13 fikni mikrofonin.

14 Më falni z. Dëshmitar që ju ndërpreva. Ju lutem vazhdoni
15 përgjigjen.

16 DËSHMITARI: Po, prej rinisë si profesion i tijna, në
17 moshën 23-24 vjeçare deri diku mosha 52 vjeçare, ka punu për
18 35 vite në polici, në ish-Jugosllavi.

19 Z. LAWS: [Përkthim] Mirë, faleminderit. Tani dua të flas
20 për ndikimin që ky kidnapim pati mbi familjen tuaj, mirë?

21 PË. Po, ndikimet kanë qenë shumë të mëdhaja, ndikime
22 emocionale. Baba ka pasë trauma.

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.
24 Dëshmitar, vazhdoni, po.

25 DËSHMITARI: Ndikimet kanë qenë emocionale, shpirtërore.

1 Baba ka pasë trauma psikologjike, i shkatërrum nga plagat që i
2 ka marrë në kampin e mbajtjes në Kukës.

3 PY. Por, ju çfarë vute re ndryshe tek ai? Çfarë ndryshimi
4 vutë re?

5 PË. Ndryshimet - normal, përkeqësimi i shëndetit dhe të
6 gjitha me radhë sëmundje kohë pas kohe, domethënë deri këtu ku
7 ka kalu me, në përcjellje në personin e dytë. Domethënë kanë
8 shkaktu verbimin e syve, ka ardhë verbimi i syve, dhe të
9 gjitha ato i ka fitu nga mbajtja në kampin e përqendrimit.

10 PY. Sapo përmendët fjalën "trauma". A mund t'i thoni
11 gjykatësve, ju çfarë vutë re tek babai juaj që ju bëri ju të
12 mendonit që ai po vuan, po e kalon këtë vuajtje?

13 PË. Keqtrajtimet të cilat i ka pasë aty brenda për ditët që
14 është mbajtë, kjo është.

15 PY. Po si ndryshoi ai si person për shkak të këtyre traumave?
16 Për shkak të kësaj traume që kaloi, çfarë ndryshoi tek ai si
17 person?

18 PË. Ndryshoi pak - të gjitha - në agresivitet, fjetje jo të
19 mirë, në anën psikologjike mendore, të gjitha domethënë kanë
20 ndikue. Së fundi ka ardhë verbimi i syve, ka fitu [REDAKTUAR]
21 edhe kështu.

22 PY. Po për ju si familje, si ishte? Si ishte përvoja, si
23 ishte të jetoje me këto ndryshime që kishte pësuar babai juaj.

24 PË. Përvoja ka qenë e hidhur pse jemi përball gjithë familja.
25 Përvoja ka qenë shumë e hidhur në të gjitha.

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F469RED dhe F541

1 PY. A ka ndonjë gjë që mund t'i thoni Gjykatësve, tua
2 komunikoni, tua përcillni pse ishte një përvojë e hidhur për
3 ju, nëse mund tua shtjelloni?

4 PË. Përvojë e hidhur se ndijshim shpirtnisht për ato çka
5 kishin bërë, në atë gjendje që e shifshim babain. Domethënë
6 gjatë natës ka pasë traumatizime derisa - në gjendjen jo sikur
7 ma herët para lufte. Mbas lufte gjendja e tij ka ndryshu në
8 mënyrë drastike.

9 PY. Faleminderit. Dua t'ju pyes edhe për një gjë tjetër, një
10 aspekt tjetër. Gjatë kohës që e mbanin të ndaluar, ato 13
11 ditët që qe i larguar. Si ndikoi kjo tek familja? Si e
12 përjetoi familja largimin e tij apo mungesën e tij?

13 PË. Keq. Psikologjikisht të gjithë ishin keq. Nuk dijshim
14 asgjë për të. S'kishim asnjë informacion deri në kohën kur e
15 kanë pru në banesën ku kemi jetu, [REDAKTUAR].

16 PY. Do ju bëj një pyetje më konkrete për motrat. Dhe është e
17 rëndësishme të mos u thoni emrat ju lutem. A shkonin në
18 shkollë motrat para se ta kidnaponin babain?

19 PË. Shkollën, u konë e vazhdume. Mbas lufte nuk kanë shku në
20 shkollë për punë gjendja e cila u kriju. Domethënë edhe ne si
21 vëllazën, si familje kemi pasë frikë që mos me iu ndodh diçka
22 e keqe, kështu që u duhej ta ndërprejnë shkollimin.

23 PY. Po i them këto që ta kuptojnë të gjithë këtë. Nga se
24 kishit frikë kur thoni që kishim frikë se mos u ndodhte ndonjë
25 gjë e s'mund të shkonin në shkollë. Nga se kishit frikë?

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F469RED dhe F541

1 PË. Kishim frikë se kemi qenë, shihshin në përcjellje. Edhe
2 kur jemi kthyer në Kosovë deri një kohë kemi pasë përcjellje me
3 kon po folim, kush po asi, kush po, domethënë kemi qenë në
4 përcjellje.

5 PY. Që ta kuptojmë qartë, arsyeja që po ju përcillnin - pse,
6 pse mendoni se po ju përcillnin, për çfarë arsye?

7 PË. Unë besoj që, pasi që atëherë ka ardhë UNMIK-u, e kanë
8 pasë frikën që do të dhojmë deklaratat për ta treguar të
9 vërtetën.

10 PY. Një pyetje të fundit kam për ju zotëri. Tani çfarë
11 mendoni për atë që i ndodhi babait tuaj? Tani, tash për tash
12 që jetoni me këtë situatë, si e përjetoni? Çfarë mendoni se i
13 ndodhi?

14 PË. I ka ndodhë një gjo shumë e keqe, një gjo shumë e keqe që
15 normal ka ndiku keq tek ai personalisht, tek familja në radhë
16 të dytë dhe jeta më tutje deri në këto momente. Mirëpo unë
17 këtu kam ardhë sipas fjalëve të tijna, dëshmisë së tijna, ato
18 çka kom pa unë vetë me sy se unë gjithmonë kam qenë me babanë
19 prezent, përveç në kohën e ndalimit për 13 ditë s'kom qenë me
20 të. Në raste të tjera të gjitha unë jam personi që kam qenë
21 afër tij.

22 PY. Faleminderit shumë. Nuk kam pyetje të tjera e nderuara
23 Gjykatëse.

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

25 Faleminderit, Mbrojtësi i Viktimave.

1 Z. Dëshmitar, tani kam një pyetje vijuese lidhur me
2 pyetjet që ju ka bërë Mbrojtësi i Viktimave.

3 Thatë që ndiheshit të përcjellur, sikur po ju ndiqnin.
4 Kush po ju përcillte? A mund të jepni emra?

5 DËSHMITARI: Po, grupet e tyne që kanë pasë frikë për
6 gjanat që i kanë ba në Durrës gjatë luftës, edhe se mos po
7 jepim ndonjë deklaratë për çka i ka ndodhë babait.

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
9 Faleminderit, z. Dëshmitar.

10 Tani do të vazhdojmë me pyetjet e Avokatit Mbrojtës. Para
11 kësaj sidoqoftë do të jap një urdhër gojor. Dhe para se ta bëj
12 atë sidoqoftë do të trajtojmë çështjen e kërkesës së palës
13 mbrojtëse për të shtuar një dokument specifik dhe në qoftë se
14 nuk gabohej dhe po i hedh sytë nga Mbrojtja, është një
15 dokument i cili ishte edhe në listën edhe të ZPS-së. Po, po
16 ashtu ishte.

17 Po ja jap fjalën Zyrës së Prokurorit të Specializuar dhe
18 Mbrojtësit të Viktimave për të dëgjuar se ç'kanë për të thënë
19 ata lidhur me këtë dokument.

20 Z. Prokuror, ju e keni fjalën.

21 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, ky
22 dokumenti specifik është dokumenti për të cilin nuk kemi
23 kundërshtim që të shtojmë për pyetje të saj pala mbrojtëse.
24 Nuk jam i sigurt që ka qenë një pjesë e listës së provave,
25 materialet tona. Megjithatë sido që të jetë, nuk e

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Çështje procedurale (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F541

Page 87

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F469RED dhe F541

1 kundërshtojmë përdorimin nga ana e tyre, të nderuar Gjykatës.

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] [Nuk
3 ka mikrofon] Do ta kontrolloj por ju thoni që nuk është në
4 listën tuaj, kështu? Dua që ne si Trup Gjykues ta dimë që
5 bëhet fjalë për këtë dokument në fjalë.

6 Z. DE MINICIS: [Përkthim] E nderuar Gjykatëse,
7 informacioni...

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
9 Megjithatë, preferoj që të kalojmë në seancë private për një
10 çast me qëllim që të mos lejojmë nxjerrjen e informatave
11 konfidenciale.

12 Dhe dua që të mos diskutojmë asgjë, të cilën nuk dua ta
13 dëgjojë dëshmitari. Dua të shmangim situatën që të mos e
14 detyrojë të dalë nga në salla dhe të kthehet prapë.

15 Znj. Sekretare a mund të kalojmë në seancë private, ju
16 lutem?

17 ~~{Seancë private}~~ [Seancë e hapur] Riklasifikuar në
18 bazë të F54

19 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës
20 jemi në seancë private.

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
22 Faleminderit, znj. Sekretare. Dhe ajo që shoh është një datë e
23 ndryshme. Shoh që pala mbrojtëse po pohon me kokë. A mund ta
24 konfirmoni?

25 Z. GILISSEN: [Përkthim] Po, e shoh që nuk është në listën
e ZPS-së.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Çështje procedurale (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F541

Page 88

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F469RED dhe F541

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po,
2 bëhet fjalë për një ditë tjetër. Është i njëjti gjykim, po
3 bëhet fjalë për një ditë tjetër apo jo?

4 Dëgjova juve që thoni që nuk jeni kundër përdorimit të
5 këtij dokumenti.

6 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës nuk kemi
7 kundërshtim për përdorimin e këtij dokumenti nga pala
8 Mbrojtëse.

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
10 Mbrojtësi i Viktimave?

11 Z. LAWS: [Përkthim] Edhe ne nuk kemi kundërshtim.

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
13 Dakord, kjo është e qartë. Atëherë nuk kemi patur nevojë fare
14 të kalojmë në seancë private.

15 Znj. Sekretare, a mund të kalojmë në seancë të hapur edhe
16 njëherë?

17 ~~{Seancë e hapur}~~

18 SEKRETARJA E GJYKATËS: Jemi në seancë publike tani të
19 nderuar Gjykatës.

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
21 Faleminderit, znj. Sekretare.

22 Së pari, do të japim një urdhër lidhur me një çështje
23 tjetër që ka të bëjë me listat e palës Mbrojtëse.

24 Urdhri gojor është kështu. Paneli vëren që pala Mbrojtëse
25 synon që gjatë pyetjeve për dëshmitarin të shfrytëzojë

1 materialet e nxjerra sërish. Ky është materiali ERN DPS00065
2 deri me numrat e fundit 68, i cili është nxjerrë më datën 24
3 mars 2023 si pjesë e paketës së nxjerrjes 113. Paneli vëren që
4 pala Mbrojtëse nuk ka kërkuar leje nga Trupi Gjykues për
5 shfrytëzimin e këtij materiali dhe e kujton Mbrojtjen për
6 udhëzimet e dhëna nga Trupi Gjykues në dosjen 434, paragrafi
7 44.

8 Sidoqoftë, Paneli i Trupit Gjykues vëren se materiali
9 është i kufizuar, nuk ka patur kundërshtime nga ZPS-ja dhe
10 Mbrojtësi i Viktimave dhe e autorizojmë Mbrojtjen për ta
11 shfrytëzuar këtë material.

12 Dhe pra autorizojmë që materiali të shtohet në listë, pra
13 materialin të cilin e diskutuam.

14 Trupi Gjykues e sqaron për palët dhe Mbrojtësin e
15 Viktimave që pritet që ju duhet të nxirrni, pritet që të
16 nxirrni të gjitha materialet që doni të shfrytëzoni gjatë
17 pyetjeve, në momentin më të fundit brenda afatit të caktuar
18 nga Trupi Gjykues për sa i përket materialeve që do të
19 shfrytëzoni apo kërkonit të shfrytëzoni. Të gjitha materialet
20 që nxirren në ditën kur nxirret, kur i dorëzohet lista Trupit
21 Gjykues si më parë do të cilësohet si material i cili nuk
22 është nxjerrë më parë sipas paragrafit 44.

23 Dhe çdo gjë është bërë - pra, kjo është për ato që janë
24 bërë në ditë e duhur apo më parë.

25 Duhet të kërkonit leje nga Trupi Gjykues për shfrytëzimin

1 e materialeve të nxjerra sërish me material, duke e paraqitur
2 atë në listën e materialeve që synoni të shfrytëzoni dhe këtë
3 e-mail t'ia dërgoni Trupit Gjykues.

4 Duhet të shfrytëzoni këtë material edhe në qoftë se nuk e
5 keni marrë autorizimin tonë. Pra, këtë material duhet ta keni
6 të përfshirë në listën e dokumenteve, me qëllim që ta kemi të
7 gjithë këtë listë në tërësinë e saj. Edhe në qoftë se pritet
8 autorizimi i Trupit Gjykues.

9 Trupi Gjykues do ta nxjerrë vendimin mbi kërkesën përpara
10 shfrytëzimit të këtij materiali. Dhe kjo është në përputhje me
11 paragrafin 44 deri në 49 të vendimit mbi ecurinë e çështjes.
12 Kisha përshtypjen se do të duhej të jepja këto sqarime këtu në
13 sallën e gjyqit, prandaj po e shpjegoj këtë sërish. Dhe
14 shpresoj që tani të jetë e qartë. A ka pyetje? Unë po i hedh
15 sytë nga Prokuroria.

16 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, për sa i
17 përket fotografive nuk kemi ngritur kundërshtime për shkak se
18 ka të dhëna se çfarë janë këto dokumente, për çfarë do të
19 shfrytëzohen në Legal Workflow. Megjithatë unë shpresoj që të
20 shfrytëzohen nga pala Mbrojtëse me dëshmitarin për të sjellë
21 sqarime të mëtejshme.

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
23 Faleminderit.

24 Mbrojtësi i Viktimave, dëshironi të shtoni ndonjë gjë.

25 Z. LAWS: [Përkthim] Jo, nuk kam asgjë për të shtuar e

1 nderuar Gjykatëse.

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Pashë
3 një nga Avokatët e Mbrojtjes që është ngritur në këmbë.

4 Ju e keni fjalën.

5 Z. AOUBINI: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar Gjykatës
6 për sqarimin.

7 Dhe në bazë të këtij sqarimi dhe duke qenë që mund të
8 duhet ta shfrytëzojmë këtë material të nxjerrë sërish edhe me
9 dëshmitarët e tjerë. A do të prisni ju që ne të kërkojmë leje
10 për shfrytëzimin e tij?

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po,
12 se përndryshe do të ishte shumë hutuese. Nuk ka nevojë që të
13 shpenzojmë shumë kohë, por është mirë që ta bëjmë këtë në
14 sallën e gjyqit - po këtë përmes një e-maili pasi do të ishte
15 mirë që të ishte në radhën e materialeve që do të paraqiten
16 këtu në sallën e gjyqit.

17 Z. AOUBINI: [Përkthim] Dakord, atëherë do ta bëjmë këtë
18 kërkesë më pas.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
20 Atëherë kemi arritur në momentin kur ju japim fjalën juve
21 Avokatët e Mbrojtjes për të bërë kundërpjetje për dëshmitarin.

22 Z. Dëshmitar, tani e ka radhën pala Mbrojtëse për tu bërë
23 pyetje.

24 Z. GILISSEN: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar
25 Gjykatës. Faleminderit.

1 Pyetje të palës tjetër nga z. Gilissen:
2 PY. Mirëdita z. Dëshmitar. Unë jam Jean-Louis Gilissen,
3 Avokati i Mbrojtjes i z. Shala siç e dini ju. Në këtë Gjykatë,
4 dëshmitarët vijnë dhe japin dëshmi nën betim, atë betim që
5 keni bërë në mëngjes. Kështu që unë do t'ju bëj disa pyetje.
6 Mos kini frikë. Këto nuk janë pyetje me spec. Dua të them
7 thjesht që synimi i këtyre pyetjeve është për të kuptuar sa më
8 mirë deklaratën që keni dhënë dhe për të sqaruar disa nga
9 çështjet që keni ngritur me qëllim që të mos ketë keqkuptim të
10 sqarimeve që jepni ju.

11 Pra, në qoftë se nuk e kuptoni pyetjen, mos ngurroni ta
12 thoni një gjë të tillë. Unë do të përpiqem ta riformuloj apo a
13 përsëris. Faleminderit.

14 Z. GILISSEN: [Përkthim] Unë besoj që pyetjen e parë mund
15 ta bëjmë në seancë publike. Do të përpiqem ta bëj në atë
16 mënyrë dhe do të varet sigurisht nga përgjigjja që do të
17 marrim siç e thatë ju, pra nga përgjigjja e dëshmitarit, nga
18 ajo do të varet nëse do të duhet të jem në seancë të hapur apo
19 të mbyllur.

20 PY. Z. Dëshmitar, sot në mëngjes ju shpjeguat që jetuat në
21 një fshat, e treguat emrin e tij dhe thatë që kjo ishte në
22 shtëpinë e gjyshes. A mund të na shpjegoni se çfarë kishte
23 rreth kësaj shtëpie, pra rreth kësaj ndërtese?

24 PË. Po mendon rreth shtëpisë? Ditën kur ka ndodhë rrethimi i
25 shtëpisë apo si?

1 Domethënë rreth shtëpisë ka qenë gardh i thom ne, jo muri
2 me blloka po gardh. Ditën kur ka ndodhë rasti dy person ka
3 qenë mrena në oborr dhe të tjerët kanë qenë prapa gardhit.
4 Gardhi ka pasë distancë. Largësia mes gardhit dhe shtëpisë ka
5 qenë 20-25 metra.

6 PY. A jeni në gjendje që të bëni një vizatim të shtëpisë
7 përfshirë edhe gardhin dhe rrugën që ishte në pjesën ballore
8 të shtëpisë me qëllim që ne ta kuptojmë realisht sesi ishte ai
9 vend aty?

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] A
11 është e mundur një gjë e tillë? Është e mundur të bëhet një
12 gjë e tillë që t'i kërkojmë dëshmitarit që të bëjë një
13 vizatim?

14 [Trupi Gjykses dhe Sekretarja e Gjykatës
15 këshillohen]

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj.
17 Asistente a mund ta ndihmoni dëshmitarin që të përpiqet të
18 bëjë një skicë në ekran?

19 Dhe do t'i kërkoj dëshmitarit nëse e ka të qartë se çfarë
20 kërkon nga ai Avokati i Mbrojtjes. A e kuptoni pyetjen që ka
21 bërë Avokati i Mbrojtjes?

22 DËSHMITARI: [Përkthim] Po, plotësisht. Unë po mendoj që
23 po kërkon shtëpinë, rrethin e gardhin, nga rruga kryesore
24 rruga për në shtëpi.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

1 Dakord, vazhdoni atëherë.

2 DËSHMITARI: [Përkthim] Domethënë përafërsisht skicë është
3 kjo.

4 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Sa
5 për procesverbal, dëshmitari ka bërë një skicë dixhitale
6 kompjuteristike me kërkesën e Avokatit Mbrojtës. Nuk do ta
7 përshkruaj ekzaktësisht se për çfarë bëhet fjalë, thjesht për
8 të thënë që janë tre shtëpi, një rrugë dhe diçka që mund të
9 përshkruhet si një gardh, pasi edhe kjo është pjesë e
10 procesverbalit të çështjes gjyqësore.

11 Avokati i Mbrojtjes mund të vazhdoni.

12 Z. GILISSEN: [Përkthim] Faleminderit.

13 PY. Z. Dëshmitar, besoj që vija që shoh në këtë skicë është
14 gardhi, është rruga dhe pastaj gardhi. A mund të vini numrin 1
15 për rrugën dhe 2 gardhin?

16 PË. [Shënon].

17 PY. Faleminderit.

18 PË. Plus rruga për në shtëpinë time.

19 PY. Po, kjo ishte pyetja ime. Kjo është hyrje për në shtëpi
20 apo jo?

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Unë
22 shoh numrin 1, shoh numrin 2 dhe tani shoh edhe numrin 3. Dhe
23 numri 3 ishte rruga që të çon tek hyrja e shtëpisë.

24 Z. GILISSEN:

25 PY. Dhe sipas jush distanca mes shtëpisë dhe gardhit ishte

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: TW4-08 (Seancë e hapur)

Faqe 95

Pyetje të palës tjetër nga z. Gillisen

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F469RED dhe F541

1 rreth 25 metra, kështu thoni?

2 PË. 20-25 metra.

3 PY. Faleminderit, është e qartë.

4 Atë ditë më datën [REDAKTUAR] të 1998-s [sipas
përkthimit].

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Cila është

6 data që thatë ju?

7 Z. GILISSEN: [Përkthim] [REDAKTUAR] maj 1898, 1998.

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

9 [REDAKTUAR] maj? Unë, nuk po i bëj unë pyetjet. Nuk jam e
10 qartë se për cilën datë dhe për cilin vit e keni fjalën.

11 Z. GILISSEN: [Përkthim] E përsëris, data [REDAKTUAR] maj
1998.

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

13 Faleminderit.

14 Z. GILISSEN: [Përkthim] Nëse kam bërë ndonjë gabim, ju
15 kërkoj ndjesë.

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Nuk
17 bëhet fjalë për thjesht gabime, por duam që t'i kemi të gjitha
18 datat e sakta për vitin 1998 dhe për 1999-n.

19 Z. GILISSEN: [Përkthim] Dakord. Jam dakord.

20 PY. Unë shpresoj që ta kuptoni pyetjen. Dua të di se ku ishe
21 ti vetë kur erdhën këto grupet e armatosura? Ku ishit ju kur
22 erdhën ato tek shtëpia juaj?

23 PË. Në shtëpi mbrenda. Dhe kam dalë përjasht kur kanë ardhë
24 ata.

25 PY. Kush i ka parë kur erdhën? Kush i ka parë? Kush ishte i

1 pari që i ka pa duke ardhur?

2 PË. I kemi pa na për dritare tuj ardhë. Kanë vozu, kemi dalë
3 ne të gjithë në oborr, nona, vllaznit, motrat.

4 PY. Katër persona, nëse ju kuptoj si duhet?

5 PË. Dy persona kanë mbrenda, të tjerët kanë qenë te gardhi.

6 PY. Jo, pyetjen e kam për njerëzit që i kam parë duke ardhë.

7 Thatë mamaja, ti vetë dhe dy vëllezërit. Katër persona, katër
8 veta ishit ju që i keni pa ata kur kanë ardhur?

9 PË. Kemi qenë gjithë familja në shpi. Ka qenë baba, kanë qenë
10 motrat, kemi qenë na. Po, unë, dy vllaznit dhe nona kemi dalë
11 jashtë. Ju kemi lut babës që të rri mbrenda, të bisedojmë na
12 me ta për të mos me ardhë deri këtu ma e keqja. Kështu që kemi
13 bisedu, e kanë marrë revolen dhe kanë ikë në drejtimin e...

14 PY. Po ju thatë që ju i patë duke ardhur. Çfarë keni pa në
15 atë moment? Kanë ardhur në këmbë? Kanë ardhur me makine,
16 çfarë, si?

17 PË. Kanë ardhur më këmbë. Dy persona kanë ardhur rrugës dhe
18 deri këtu në oborrin, këtu kanë qenë këta dy persona.
19 Domethënë të tjerët kanë qenë këtu tek gardhi, në anën e
20 rrugës, të mbulum prej gardhit dhe armët në drejtim të
21 objektit.

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.

23 Dëshmitar, me qëllim që të gjithë të mund ta kuptojmë, dy herë
24 ju thatë fjalën këtu, këtu. Po unë nuk e shoh se për çfarë
25 bëhet fjalë kur thoni "këtu". A mund ta shënoni, a mund të

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: TW4-08 (Seancë e hapur)

Faqe 97

Pyetje të palës tjetër nga z. Gillisen

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F469RED dhe F541

1 vini një "X", germën "X" për njerëzit që ishin afër gardhit
2 dhe dy germa "XX" tek vendi ku ti vetë dhe ju të tjerët ishit
3 aty jashtë shtëpisë.

4 DËSHMITARI: [Përkthim] [Shënon].

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

6 Faleminderit, z. Dëshmitar.

7 Z. GILISSEN:

8 PY. Ju po e përshkruani shumë mirë dhe qartë kur thoni që dy
9 persona erdhën në oborr dhe pastaj thatë, folët për njerëzit
10 të cilët nuk kanë hyrë në oborr. A mund të na tregoni se çfarë
11 kanë bërë të tjerët, ata të cilët nuk kanë hyrë në oborr? A
12 mund të na shpjegoni këtu në këtë skicë, sipas skicës që keni
13 bërë?

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Me sa
15 e kuptoj unë, ai vendosi një kryq, pra germën "X" për njerëzit
16 të cilët ishin në afërsi të gardhit.

17 Z. GILISSEN: [Përkthim] Ka vendosur vetëm një, por ne e
18 dimë që ka patur një numër të madh njerëzish. Doja të dija
19 nëse bëhet fjalë për një grup në këtë vend apo bëhet fjalë për
20 një numër të madh njerëzish si një ushtri si të thuash.

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.
22 Dëshmitar, a mund të na tregoni se ku ishin ata njerëzit që
23 ishin në këmbë te gardhi dhe si ishin të pozicionuar, në
24 ç'mënyrë rrinin?

25 DËSHMITARI: Të pozicionuar kanë qenë të gjithë nga këtu

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: TW4-08 (Seancë e hapur)

Faqe 98

Pyetje të palës tjetër nga z. Gillisen

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F469RED dhe F541

1 deri këtu. Këtu ka qenë një person me tromblon. Dorën e ka
2 pasë këtu në gardh. Këtu kanë qenë dy persona. Këtu nalt, lart
3 kanë qenë dikund 10 deri në 15 persona. Dy kanë ardhë në rrugë
4 këtu ku kemi komunikuar me ta. Këta këtu te gardhi e kanë mbulu
5 komplet shtëpinë dhe këtë pjesën këtu ku kanë qenë këta dy
6 personat me gjithë neve. Të gjitha armët kanë qenë në drejtim
7 tonin.

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.

9 Avokat, për ta bërë këtë qartë këtë situatë, megjithatë do
10 t'jua lë juve pasi janë pyetjet tuaja për tu bërë. Po shohim
11 këtu që kemi disa pika disa kryqe po nuk na mjaftojnë për ta
12 shfrytëzuar në mënyrën e duhur. Më vonë kur të na duhet ta
13 shqyrtojmë.

14 Z. GILISSEN:

15 PY. Atëherë, a ka hyrë ndokush brenda në shtëpinë, në
16 ndërtesën e shtëpisë?

17 PË. Jo. Ka hyrë në oborr. Ajo është ndërtesa e shtëpisë, kjo
18 është rruga e familjes time. Kjo është rrugë private, nuk
19 është, nuk ka qenë rrugë shoqërore, rrugë private e familjes
20 time, pronë e imja. Këta kanë hy në pronën time dhe në murin e
21 pronës time të pozicionum. Muri ka qenë pronë e imja.

22 PY. Faleminderit. A mund të vendosni një kryq në pozicionin
23 ku ishit kur njerëzit hynë në oborr?

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Unë
25 propozoj të vendosi numrin 5, pasi përndryshe kemi numër shumë

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: TW4-08 (Seancë e hapur)

Faqe 99

Pyetje të palës tjetër nga z. Gillisen

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F469RED dhe F541

1 të madh kryqesh. A mund të vendosni numrin 5 për të treguar se
2 ku ishit ju vetë, ti vetë, ku ishe ti vetë duke qëndruar?
3 Megjithëse, më duket se e keni bërë një gjë të tillë.

4 Z. DE MINICIS: [Përkthim] A mund ta them këtë?

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

6 Vazhdoni, vazhdoni.

7 Në qoftë se keni për të diskutuar diçka mbi përmbajtjen
8 atëherë dakord do ta lejojmë të dalë nga salla.

9 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Unë e di që dëshmitari ka
10 treguar se ku ndodhej.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po,
12 edhe unë ashtu të thashë që dy kryqe të vendosura aty ishin
13 ato, ishte vendi ku ishin dy anëtarët e familjes dhe unë
14 propozova që aty të vendosnim numrin 5.

15 Më nuk do të kalojmë në një temë tjetër por do të doja
16 këtë.

17 Z. Dëshmitar, ku ishe ti vetë në atë moment, në ç'vend?
18 Aty vendosni numrin 5.

19 DËSHMITARI: [Shënon] Këtu.

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

21 Vendosni numrin 5. Ndoshta mund ta vendosni pak më poshtë me
22 qëllim që ta shohim si duhet.

23 DËSHMITARI: [Shënon]

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

25 Faleminderit.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: TW4-08 (Seancë e hapur)

Faqe 100

Pyetje të palës tjetër nga z. Gillisen

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F469RED dhe F541

1 Z. Avokat, më lejoni të sqaroj disa pyetje të tjera pasi
2 nuk dua që të mbeten pezull.

3 Personi me atë minahedhësin ku ishte? Në ç'vend ishte?
4 Unë besoj se e di se ku por nuk dua që t'ju fus fjalë në gojën
5 tënde. A mund të vendosni numrin 6 për këtë?

6 DËSHMITARI: [Shënon]

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë
8 mirë. Po personat që po qëndronin ngjitur me gardhin, keni
9 vendosur një kryq, a po rrinin bashkë grumbull apo ishin të
10 shpërndarë?

11 DËSHMITARI: Nga këtu deri këtu. Nga këtu deri këtu,
12 domethënë përgjatë gjithë gardhit.

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
14 rregull. Atëherë nëse mund të vendosni te kryqi në të majtë
15 një 7, një numër 7, aty ngjitur me atë gardhin.

16 DËSHMITARI: [Shënon]

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë.
18 Edhe një 7 në kahun tjetër, në fillim të gardhit, nga fillimi
19 ku po qëndronin deri në fund, 7 në fillim.

20 DËSHMITARI: [Shënon]

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Për
22 procesverbal mes dy shtatave ka pasur persona që qëndronin
23 përgjatë gardhit, kështu?

24 Shumë mirë.

25 Vazhdoni, Avokati Mbrojtës.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: TW4-08 (Seancë e hapur)

Faqe 101

Pyetje të palës tjetër nga z. Gillisen

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F469RED dhe F541

1 Z. GILISSEN:

2 PY. E pashë kryqin po ne duam të kuptojmë ku ishte mamaja, ku
3 po qëndronte mamaja dhe ku po qëndronin vëllezërit nëse mund
4 të na e tregoni te kjo skica. Në ç'vend po qëndronin?

5 PË. Kur kemi dalë na, kemi dalë në oborr. Këtu ka qenë
6 familja jonë, këtu, këtu, këtu edhe këtu te e 5-ta. Kurse këta
7 dy iksat janë dy personat që kanë ardhë këtu dhe këtu na kemi
8 bisedu, jemi shty derisa ja kanë marrë vllaut revolen. Edhe me
9 atë revole janë largu me qëllim që nona ju ka thonë se unë
10 nesër vimë komplet në shtab në Jabllanicë.

11 PY. Dakord, po nuk ishte kjo pyetje ime. Unë dua të di vendin
12 ku po qëndronte mamaja dhe vëllezërit.

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shiko
14 çfarë propozoj unë. Vendosni një 8 dhe një 9, 8a për vendin ku
15 qëndronte mamaja dhe 9a për vëllezërit.

16 DËSHMITARI: [Shënon] Po na gjatë kësaj kohe kemi pasë
17 edhe lëvizje në të majtë, në të djathtë. Kemi ndru pozicionet,
18 s'kemi nejt vetëm me një vend, se ne jemi konë aty para një
19 sulmi.

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
21 Faleminderit. Po bëni vërtet shumë përpjekje.

